



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Infermieri  
Klinike”  
Universiteti “Aldent”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Dr. Nevila HETA**

**Dr. Elda NUNI**

**Tetor / 2020**

## **TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

### **Për Programin e studimit: Msc në “Infermieri Klinike”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aldent”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Msc në Infermieri Klinike
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 191, datë 20.04.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	12 PAE / 11 PAK
18	Numri i studentëve:	54 studentë
19	Komente / të tjera:	-



## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në kuadrin e akreditimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në: “Infermieri Klinike”, kërkuar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aldent”, është realizuar procesi respektiv i vlerësimit sipas agjendës së miratuar nga dy institucionet. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet që kanë dalë si rezultat i analizës për procesin e vlerësimit të jashtëm. Universiteti “ALDENT ” (UA) është institucion jo publik i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 673, datë 22.09.2006, me statusin Shkollë e Lartë Universitare. Përgjatë viteve ky IAL ka pësuar një sërë ndryshimesh si në emërtim dhe në strukturën e tij. Me VKM Nr. 539, date 13.06.2013, ndryshon statusi nga shkollë e lartë universitare private “Aldent” në Universitet, me emërtimin Universiteti “Aldent”. Me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkences Nr. 305, datë 24.07.2013, riorganizohet institucioni në 2 Fakultete, në përputhje me Vendimin Nr. 442, datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit. IAL ka kaluar disa procese vlerësimi dhe akreditimi të njësisve kryesore si dhe te akreditimit institucional. Me Urdhër të MAS Nr. 115, datë 13.07.2017 hapet Njesia Kryesore Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Me UMAS Nr. 111, datë 11.03.2016 Universiteti Aldent ka kaluar akreditim periodik institucional, në përputhje me Vendimin Nr. 124, datë 18.02.2016 të Këshillit të Akreditimit. Së fundmi, Institucioni ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.114, datë 15.12.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 14.12.2022.

Struktura akademike e Universitetitv “ALDENT”, aktualisht përbëhet nga tre njësi kryesore:

### 1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore me:

- Departamenti i Farmacisë;
- Departamenti i Formimit Mjekësor;
- Qendra Kërkimore Farmako-Terapeutike;

### 2. Fakulteti i Shkencave Dentare me:

- Departamenti i Laborantëve Dentarë;
- Departamenti i Stomatologjisë;
- Qendra e Shërbimit dhe Formimit Klinik;

### 3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike me:

- Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë;
- Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri;
- Qendra e Promovimit të Shëndetit;



Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri Klinike” ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Programi i studimit Master i Shkencave në Infermieri Klinike është hapur me Urdhër të MAS Nr. 191. datë 20.04.2018 me formë studimi me kohë të plotë, 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Raporti i vlerësimit të jashtëm përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kriterëve të ciklit të dytë për Masterin e Shkencave, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësim e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kriterëve respektive. Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura, janë shqyrtuar një sërë dokumentesh dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. I gjithë dokumentacioni i referuar, jepet në fund të këtij raporti dhe është i renditur sipas listës numerike të paraqitur në këtë aneks. [ankesi lista e evidencave] Procesi i vlerësimit është administruar nga Koordinatori teknik nga ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UA, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Dr. Nevila Heta Alliu, dhe Dr. Elda Nuni. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

Vlerësimi i brendshëm ku institucioni ka dorëzuar Raportin e vlerësimit të brendshëm së bashku me dokumentacionin mbështetës (DVB). Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj fazë janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimit dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive. Vizita në UA e zhvilluar në datat dhe 25 dhe 26 Qershor. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit. Raporti i vlerësuesve të jashtëm bazohet në dokumentacionin e dorëzuar nga UA, informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit të cilat kanë ndihmuar në arritjen e konkluzioneve mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi.

Universiteti Aldent është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 29.09.2020, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 25/7 Prot, datë 29.09.2020. Universiteti Aldent përcjell në ASCAL më datë 05 tetor, me anë të shkresës me Nr. 59 Prot, datë 05.10.2020 “Përgjigje për draft raportin e vlerësimit të jashtëm”.

*Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:*

### **1. Për komentin 1 të GVB – së;**

Marrëveshjet institucionale dhe përfshirja e Universitetit në programe si CEPUS dhe ERASMUS+ janë aktive dhe kanë si objekt të tyre mobilitetin e stafit, organizimin e aktiviteteve të përbashkëta mësimore dhe shkencore si dhe shfrytëzimin e kapaciteve infrastrukturore në funksion të rritjes së cilësisë akademike. Për vitin akademik 2019- 2020 sikurse është bërë e ditur në takimin e GVJ me Komisionin e Kërkimit Shkencor, ishin parashikuar një sërë mobilitetesh të studentëve dhe stafit infermieror në institucionet e bashkëpunimit në Turqi, Gjermani dhe Poloni por, për shkak të pandemisë së krijuar nga Covid-19 momentalisht janë pezulluar për t’u realizuar në një moment më të sigurtë ndërkombëtar.

**Argumenti i GVJ:** GVJ gjatë hartimit të raportit ka shqyrtuar dhe evidentuar marrëveshjet e bashkëpunimit CEPUS dhe ERASMUS +, por ka theksuar se prej ketyre marrveshjeve nuk kanë përfituar studente dhe pedagogë posacërisht të këtij programi studimi. Gjatë takimeve me stafin dhe studentët e programit dhe në dokumentacion nuk u evidentuan mobilitete të stafit apo studenteve të këtij programi, të planifikuara dhe të anuluar si shkak i pandemisë. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

### **2. Për komentet 2 dhe 3 të GVB – së;**

Programet e ciklit të tretë për stafin akademik infermieror janë një problem i njohur në fushën akademike, megjithatë instucioni ka rekrutuar si staf akademik me kohë të plotë 2 pedagogë me doktoratë në fushën infermieristike si dhe motivon dhe mbështet stafin tjetër infermieror në projekte kërkimi dhe mundësi të rritjes akademike deri në hapjen e kuotave për studime të doktoratës me drejtim infermieror në rang kombëtar. Stafi akademik me kontratë (PAK) që është i anagazhuar në programin “Master i Shkencave” në “Infermieri Klinike” realizon vetëm 20 % të ngarkesës ndërkohë që 80% realizohet nga stafi akademik efektiv (PAE). Ky numër relativisht i lartë i stafit akademik me kontratë (PAK) lidhet me faktin se ky program studimi përmban numër të lartë modulesh ndaj, institucioni në kuadër të ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies është i interesuar të angazhojë për secilin modul pedagog të veçantë në përputhje me specialitetin e vet.

**Argumenti i GVJ:** Vlerësimi i GVJ në lidhje me realizimin e ngarkesës mësimore nga stafi PAE dhe PAK është bazuar në dokumentacionin e Institucionit përkatësisht në (*Evidencën 12 Tabelat:*



Tabela 14 dhe Tabela 14.1), dhe në (Evidencën: Ngarkesa e pedagogëve e lidhur me planin mësimor). Sic është evidentuar edhe në RVJ, në evidencën e sipërcituar, në disa prej moduleve janë vendosur emrat e dy pedagogeve dhe numri i krediteve të cilat mbulojnë është vënë i përbashkët, duke pasur mospërputhje me (Evidenca nr 12, tabela nr 14). Këto të dhëna i kanë krijuar paqartësi GVJ gjatë përlllogaritjes së raporteve të ngarkesës mesimore. **Raporti në këto pika nuk ndryshon.**

### 3. Për komentin 4 të GVB-së;

Praktikat klinike për studentët e programit Msc në Infermieri klinike është e vërtetë që zhvillohen në spitalet e të vetmes Qendër Universitare Spitalore në vend ashtu si programet e ciklit të parë por, sikurse është theksuar gjatë takimeve me GVJ studentët e këtij programi praktikohen në shërbime si Reanimacioni i përgjithshëm, Reanimacioni i Neurologjisë, Reanimacioni i Pediatriisë, Kardiokirurgji, Neonatologji që nuk parashikohen në kalendarin e praktikave të programit bachelor.

**Argumenti i GVJ:** GVJ i qëndron mendimit të shprekur në RVJ ku evidentohet që praktikat zhvillohen vetëm pranë QSUT, dhe rekomandon shtrirjen edhe në instituciona të tjera, shërbimet e cituara më lart janë shërbime të QSUT. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

### 4. Për komentin 5 të GVB-së;

Në infrastrukturën e institucionit në funksion të programeve infermierore janë 2 laboratore infermieristike që mbikqyren nga stafi infermieror i përmendur në faqen 14, kriteri 5 të RVB. Theksojmë se për këtë program studimi nuk janë parashikuar orë laboratorike pasi objektivat e masterit janë të fokusuar drejt kompetencave klinike dhe aplikimi i proceduarve në mulazhe është realizuar në programin bachelor. Gjithsesi, labororet janë në dispozicion të studentëve dhe stafit infermieror sa herë që del e nevojshme gjatë procesit akademik.

**Argumenti i GVJ:** GVJ i qëndron konstatimit se: Institucioni nuk ka angazhuar personel ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit duke mos plotësuar Kriterin 5 të Standartit II. 5. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Infermieri Klinike”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit në fjalë nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe synon të ndihmojë në ruajtjen e vlerave kombëtare duke përgatitur specialist të shëndetit që do të punojnë për këtë drejtim. Referuar statutit, programet e studimit të ofruara nga UA synojnë përgatitjen e profesionistëve në fushat respektive sipas programeve të studimit dhe janë në përputhje me misionin dhe objektivat e UA, Këto programe jo vetëm që tentojnë të ruajnë vlerat akademike dhe kulturore kombëtare, por synojnë edhe zhvillimin dhe promovimin e mëtejshëm të tyre. <i>[statuti i UA]</i> .
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	UA ofron programe në disa prej fushave kryesore shëndetësore duke synuar përgatitjen e specialistëve të shëndetit me qëllim ofrimin sa më cilësor të shërbimit ndaj pacientit dhe edukimin e tyre në vazhdim në përputhje me trendet e zhvillimit bashkëkohor. <i>[statuti i UA]</i> . Programin Msc në Infermieri Klinike është në përputhje me misionin e institucionit dhe fushën e tij të veprimtarisë
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Gjatë takimit me drejtuesit e FSHMT programi i studimit ofruar nga UA bazohet në studimin e kryer nga institucioni lidhur me nevojat e tregut të punës për infermier në përgjithësi dhe ata të specializuar në profile të vecanta. Ofrimi i këtij programi studimi është bazuar në nevojën gjithnjë e në rritje për infermierë me nivel të lartë kualifikimi, me njohuri të thelluara teorike dhe aftësi të aplikimit praktik në situata klinike. Programi ofron lënde dhe module të cilat nxisin një aftësim më të thelluar shkencor dhe profesional.
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

e thelluar profesional e shkencor				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.2</b>				
<b>Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Institucioni ka hartuar planin strategjik të zhvillimit të institucionit për vitet 2016-2020, në të cilën janë përcaktuar drejtimit strategjike të zhvillimit të programeve dhe fushave të studimit dhe kërkimit të cilat të janë në përputhje me fushën e veprimtarisë të UA, duke tentuar përmirësimin e vazhdueshëm të mësidhënies të kërkimit shkencor me qëllim përgatitjen e profesionistëve të aftë të shëndetit. Institucioni gjithashtu disponon Rregulloren e Institucionit, Rregulloren e Njesisë Kryesore, Rregulloren e Njesisë Bazë Bazuar në Statusin e UA-së, rregulloret janë në përputhje me fushën e veprimtarisë të UA, institucion i cili ofron vetëm programe të profilit mjekësor dhe gjithashtu programi është në përputhje të plotë me profilin e institucionit. <i>[Rregulloret, takimi me drejtuesit].</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstron se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohet në përputhje me fushat e drejtimit akademik të institucionit. <i>[Statusi UA-së, Rregullorja UA-së, Plani i Zhvillimit Strategjik të UA]</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri Klinike” është emërtuar, organizuar dhe strukturuar në përputhje me fushën e veprimtarisë akademike së UA, ai ofrohet dhe zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe tendencat globale të zhvillimit duke ju referuar nevojave të tregut të punës.			
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit				
<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Nuk</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)






standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit paraqet në mënyrë përmbledhëse objektivat e tij [rregullorja e programit, kurrikula].</p> <p>Bazuar në këto objektiva, programi i ciklit të dytë Msc në Infermieri Klinike synon të përgatisë specialistë për fushën profesionale dhe të kërkimit shkencor në fushën e Infermieristikës Klinike duke mundësuar zhvillimin e një karriere të ardhshme akademike dhe të kërkimit shkencor.</p> <p>Masteri i Shkencave në Infermieri Klinike synon të formojë të diplomuarit ne Infermieri si ekspertë të cilët do të luajnë një rol të rëndësishëm në cilesinë e përkujdesjeve infermirore dhe sigurinë e pacientit. Programi ka qëllim të aftësojë studentin që në ushtrimin e profesionit të tij si infermier duke arritur kompetencë në vendosjen në mënyrë të pavarur të diagnozës infermirore duke përdorur njohuritë teorike dhe klinike, në orientimin e individëve, familjeve dhe komunitetit drejt jetës së shëndetëshme dhe kujdesit ndaj vetes.</p> <p>Të këtë aftësinë që në mënyrë të pavarur të marrë masa për shpëtimin e jetëve në raste krizash apo fatkeqësish, të këshillojë, të instruktojë dhe të mbështesë personat që kanë nevojë për përkujdesje, si dhe të afërmit e tyre, mënyrë të pavarur të vlerësojë dhe të japë një shërbim shëndetësor sa më cilësor. Organizimi i lëndëve dhe gjithashtu përfshirja në kurrikul e lëndëve të cilat i orientojnë dhe aftësojnë drejt kërkimit shkencor krijon mundësinë e zhvillimit të aftësive dhe kompetencave të duhura në përputhje me nivelin e studimit dhe me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ, identifikoi se institucioni dhe drejtuesit, marrin informacione për nevojat e tregut të punës në mënyra të ndryshme, si nëpërmjet studimit të tregut të punës,</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat</p>	




<p>e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>takimeve të zhvilluara më pedagogë, drejtuesit e urdhërit të infermierit apo drejtues të institucioneve shëndetësore.</p> <p>Institucioni ka bashkëpunim me agjensi ndërmjetësuese për punësimin e studenteve në vendet evropiane dhe gjithashtu ka kryer një studim të tregut të punës brenda vendit duke evidentuar zhvillimin e vullshëm si në teknologjinë mjeksore ashtu edhe në metodat dhe protokollet e avancuara të diagnostikimit dhe mjekimit. (<i>Studim tregu, Marrëveshje bashkëpunimi DEKRA, AUXILA</i>)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, synojnë kualifikim më të thelluar të infermiereve por krijojnë mundësinë e zhvillimit të mëtejshëm në fushën akademike, shkencore, organizative, të ruajtjes dhe promovimit të shëndetit. (<i>Rregullore e programit, Objektivat</i>)</p> <p>GJV vlerëson se niveli i dijeve të ofruara në programet e lëndëve është i përshtatshëm për nivelin e ciklit të dytë të studimeve, programi ka lëndë të cilat janë thellim i lëndëve të zhvilluara në ciklin e parë të studimeve (<i>Programi i studimit Bachelor në Infermieri</i>), dhe gjithashtu lëndë të reja në përpudhje me kërkesat e një programi Master Shkencor.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit, objektivat formues janë shprehur qartë, gjithashtu struktura dhe përmbajtja e programeve garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. Për hartimin e programit Institucioni referon të ketë marrë për bazë programet e ngjashme të ofruara nga institucione kombëtare. (FSHMT,UMT). <i>Nuk ka referenca të konsultimit më programe të tjera ndërkombëtare.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të</p>	<p>Një nga komponentët më të rëndësishëm të programit është praktika profesionale, e cila mundëson përdorimin e njohurive teorike të fituara, kombinimin e tyre me njohuri praktike dhe krijimin e lidhjeve për punësim të mëtejshëm. Ndërthurja e njohurive teorike me kryerjen e praktikës profesionale i mundëson studentëve formimin profesional për përshtatjen e tyre në tregun e punës. Praktika profesionale ju mundëson studentëve njohjen nga afër me detyrat që do të ketë infermieri i cili do të punësohet në pozicione pune të ngjashme. Institucioni ka disa marrëveshje me</p>

vendeve evropiane.	Institucione Shëndetësore, sic janë QSUT, Spitali Universitar i Traumës, Spitali Koco Gliozheni.			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Në programin e studimit Master i Shkencave në Infermieri Klinike nuk përfshihen elemente të mësimdhënies, module apo lëndë në gjuhë të huaj, në RVB deklarohet se Institucioni e synon këtë objektiv në të ardhmen.  GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në instucion konstatoi se vetëm një pjesë e dokumentacionit të programit Master i Shkencave në Infermieri Klinike ruhet dhe arkivohet në gjuhën angleze.			
<b>Kriteri 7.</b> Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.				
<b>Kriteri 8.</b> Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi I.4</b>	
<b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Institucioni UAL ka një eksperiencë disa vjeçare në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë (hapur me VKM VKM Nr. 673, datë 22.09.2006, dhe akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit ), çka tregon se tashmë institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon <i>[vizita e ambienteve]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i Studimit Master i Shkencave në “Infermieri Klinike” ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, fusha e veprimtarisë së të cilit përputhet me atë të programit të studimit.  Ky Departament është pjesë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike , i cili përbëhet nga këto njësi bazë:  1. Departamenti i i Infermierisë dhe Fizioterapisë; 2. Departamenti i Laborant Mjekësor dhe Imazheri; 3. Qendra e Promovimit të Shëndetit;
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje	Fusha së cilës i përket Programi i Studimit Master Shkencor në “Infermieri Klinike” është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, sipas klasifikimit/kodifikimit të programit referuar direktivave kombëtare dhe evropiane. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë përgjegjës për ofrimin e këtij programi studimi ofron dy programe të ciklit të parë dhe dy programe të ciklit të dytë.  Referuar ( <i>evidencës nr. 12, tabela nr 2</i> ), konstatohet se Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike për vitin akademik 2019-2020, ka gjithsej <b>71 pedagogë</b> , nga të cilët <b>27 janë pedagogë efektivë (PAE)</b> , nga ku 9 me grada /tituj, dhe <b>44 pedagogë me kontratë (PAK)</b> nga ku 14 me grada/tituj.  Referuar ( <i>evidencës nr. 12, tabela nr 3</i> ), konstatohet se Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë që është përgjegjës për programin e studimit, për vitin akademik 2019-2020 ka gjithsej <b>28 pedagogë</b> , nga të cilët <b>10 janë pedagogë efektivë</b>

	<b>(PAE) dhe 18 jane pedagogë me kontratë (PAK).</b>			
	Kualifikimi i tyre është:			
	<b><u>PAE</u></b>	<b><u>PAK</u></b>		
	1 Prof.As	2 Prof.As		
	2 Dr	1 SPA		
	7 Msc	7 Dr		
		8 Msc		
	<i>Ky program nuk është një program ndërdisiplinor dhe është brenda profilit të institucionit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Në funksion të programit të studimit, institucioni ka angazhuar të gjithë strukturën dhe logjistikën që disponon. Gjatë vizitës në Institutin GVJ evidentoi marrëdhënie të ngushta mes strukturave akademike dhe administrative, ndërmjet Fakulteteve si dhe Departamenteve të të njëjtit Fakultet, ku detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre strukturave dhe personelit specifikohen në Statusin dhe rregulloret përkatëse. Kjo gjë mundëson dhe lehtëson mbarëvajtjen e programit të studimit.  Për realizimin e programit të studimit Master i shkencave në “Infermieri Klinike”, institucioni ka një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me Institucione të tjera të Arsimit të lartë brenda vendit të cilat ofrojnë programe të ngjashme studimi. ( <i>Evidenca nr 12, Tabelat Nr 17 Marrëveshjet e Bashkëpunimit</i> )
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me	Referuar RVB UA ka marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

<p>institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>institucione shëndetësore, brenda profilit të programeve të studimit që ofron. Keto institucione përfshijnë qendrat kryesore të shërbimit spitalor në vendin tonë si QSUT, Spitali i Traumes, Spitali Koco Gliozheni. Një pjesë e lektoreve të këtij programi studimi dhe zhvillimi i praktikave profesionale ofrohet nga këto institucione. Referuar numrit të lartë të studentëve të cilët ndjekin programet e ciklit të parë dhe të dytë në Shkenca Infermierore si në këtë institucion ashtu edhe në institucione të tjera të arsimit të lartë në Tiranë, kapacitetet e këtyre institucioneve janë të pamjaftueshëm për realizim cilësor të praktikës, nisur nga kjo</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p><i>GVJ rekomandon rritjen e numrit të marrëveshjeve më institucione të tjera shëndetsore shtetërore dhe private.</i></p> <p>Praktika mbikqyret nga koordinatori i programit i cili koordinon me institucionin ku studenti realizon praktikën profesionale. Vlerësimi i praktikës kryhet sipas regullores përkatëse të UA. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në disoizicion GVJ konstatoi se programi ka formularin e aplikimi për praktikën profesionale, formularin e vlerësimit të praktikës profesionale nga pedagogu mbikqyrës dhe institucioni ku studenti ka kryer praktikën. Formulari i aplikimit për praktikën profesionale, plotësohet nga studenti dhe i dorëzohet koordinatores së departamentit.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Instucioni është i përfshirë në programe bashkpunimi të tilla si CEPUS dhe ERASMUS të cilat kanë qëllim mobilitetin e personelit dhe studentëve, por <i>GVJ konstatoi se deri më tani asnjë nga studentët apo pedagogët e këtij pragrami studimi nuk ka përfituar nga këto marrëveshje.</i></p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ nuk evidentoi raporte analitike periodike të njësisë përgjegjëse për programin në lidhje me përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, ndërsa të dhënat e GVB janë vetëm informues dhe jo analitike.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ nuk evidentoi raporte analitike periodike të njësisë përgjegjëse për programin në lidhje me përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, ndërsa të dhënat e GVB janë vetëm informues dhe jo analitike.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ nuk evidentoi raporte analitike periodike të njësisë përgjegjëse për programin në lidhje me përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, ndërsa të dhënat e GVB janë vetëm informues dhe jo analitike.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<p><b>Nuk</b></p>	<p><b>Përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet</b></p>

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Standardi I.6				
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Institucioni deklaron se mbështet veprimtarinë kërkimore shkencore të personelit akademik dhe të studentëve. Gjatë takimit me stafin akademik dhe në RVB, u evidentua se në fillim të cdo viti akademik aprovohet një fond i posaçëm për kërkimin shkencor dhe për pjesëmarrje në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit. i cili përcaktohet sipas kërkesave, <i>por GVJ nuk ka një dokument apo evidence për të vlerësuar mbështetjen konkrete financiare të IAL për kërkimin shkencor.</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ngrre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Pranë institucionit funksionin Komisioni i Përhershëm i Kërkimit Shkencor me funksion ndjekjen dhe vlerësimin e aktivitetit Shkencor. <i>(Vendimet për komisionet e përherëshme)</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Institucioni vlerëson performancën shkencore të stafit akademik më anë të pikëzimit në formularin e performancës akademike <i>(Formulari i performancës akademike)</i> , dhe promovon anëtarët e stafit të cilët kanë arritje të matshme në aktivitetin kërkimor shkencor. Gjatë takimit me stafin akademik GVJ konstatoi se ky staf ishte i kënaqur me politikën e institucionit për promovimin dhe mbështetjen në kërkimit shkencor. Institucioni boton edhe një revistë shkencore periodike, duke promovuar veprimtarinë kërkimore-botuese. <i>(Albanian Journal of Biomedical Sciences)</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	IAL organizon prej vitesh konferencën studentore, por GVJ konstaton se asnjë nga studentet e këtij program studimi nuk ka qënë pjesëmarrës aktiv si në aktivitete shkencore ashtu dhe në botime në periodikun e IAL. <i>GVJ nuk evidenton politika të tjera në inkurajimin e studenteve drejt kërkimit shkencor.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	IAL organizon prej vitesh konferencën studentore, por GVJ konstaton se asnjë nga studentet e këtij program studimi nuk ka qënë pjesëmarrës aktiv si në aktivitete shkencore ashtu dhe në botime në periodikun e IAL. <i>GVJ nuk evidenton politika të tjera në inkurajimin e studenteve drejt kërkimit shkencor.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Master i Shkencave në Infermieri Klinike është hapur Urdhërin Nr. 191. të MASR datë 20.04.2018, me formë studimi me kohë të plotë. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, i referohet nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe organizohet në 120 (ECTS) dhe kohëzgjatje 2 vite akademike, të ndarë në katër semestra, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e arsimit të lartë 80/2015. Studimet përmbillen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master i Shkencave" <i>(Rregullorja e programit të studimit, Currikula e Programit)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.	Programi i studimit është organizuar në përputhje me VKM 41. Ky program, përmban një informacion të plotë në fushën e infermieristikës kryesisht në Specialitetet Klinike duke mundësuar vlerësimin klinik të patologjive të ndryshme, depistimin, diagnostikimin, ndjekjen, dhe zbatimin e protokolleve të kujdesit infermieror.
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Ky informacion i shërben studentit për marrjen e njohurive në fushat specifike dhe të specializuara të infermieristikës si dhe përfitimin e aftësive profesionale dhe kompetencave për të shërbyer pacientëve me etike dhe kujdesje profesionale të standarteve të larta, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit , zgjidhjen e situatave komplekse dhe përballimin e sfidave
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose	






<p>profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>gjithnjë e në rritje në shëndetin e popullatës.</p> <p>Programi i studimit reflekton nevojat që ka tregu vecanërisht për profilet specifike dhe ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. (<i>programi, plani mësimor</i>)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Njohuritë e fituara në këtë program studimi, i krijojnë mundësi studentit që të përshtatet me kërkesat e tregut të punës dhe zgjerimin e njohurive të tyre profesionale për kualifikime të mëtejshme apo ndjekjen e studimeve në ciklet pasardhëse të studimit.</p> <p>Bazuar në informacionet e marra nga takimi me studentët, pas përfundimit të këtij programi, studentët kanë fituar njohuritë dhe kapacitet e nevojshme profesionale për të ushtruar profesionin e tyre në institucionet publike dhe jo publike si dhe zgjidhjen e problematikave në praktikën e përditshme në fushën e infermierisë. Programi i studimit Msc në Infermieri Klinike është i organizuar me kohë të plotë në një vit akademik të ndarë në katër semestra në total 120 ETCS (ose 1322 orë mësimore) nga të cilat 15 ETC i përkasin praktikës profesionale dhe 15 ETC punimit të diplomës dhe provimit përfundimtar. (<i>plani mësimor</i>).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike të cilat në të dy semestrat janë organizuar në leksione, seminare, praktikë profesionale si dhe orët jashtë auditorit. Lëndët modulet janë të grupuara sipas veprimtarive formuese së bashku me ngarkesën përkatëse në kredite në përputhje me VKM nr 41/2018. Konkretisht:</p> <p>Kategoria A, 12 kredite, 10%;</p> <p>Kategoria B, 60 kredite , 50%;</p> <p>Kategoria C, 18 kredite, 15%;</p> <p>Kategoria D, 15 kredite, 12.5 %;</p> <p>Kategoria E, 15 kredite, 12.5 %;</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Frekuentimi i orëve teorike është i detyrueshëm për studentin në masën 75% ndërsa atyre praktike në masën 100%. Kohëzgjatja e orëve të mësimimit është 50 minuta. (<i>Rregullorja e</i></p>

	<i>programit te studimit)</i> Në semestrin e katërt, studentët ndjekin praktikën profesionale pranë institucioneve/qendrave shëndetësore publike dhe jo publike me të cilat institucioni ka lidhur kontratë/marrëveshje bashkëpunimi. ( <i>marrëveshjet e bashkëpunimit</i> ). GVJ konstaton se numri i ETCS/orët mësimore në auditor të paraqitura në planin mësimor përputhet me numrin e orëve në ngarkesën e plotë mësimorë të pedagogëve të përfshirë në këtë program studimi ( <b>1322 orë</b> ). ( <i>plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e pedagogëve të përfshirë në program</i> ].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	UA është organizuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutit të Universitetit. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë është njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, dhe përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. UA plotëson standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional me Vendim të BA Nr. 114, datë 15.12.2017, me kohëzgjatjen 5 vite, me afat vlefshmërie deri në 14.12.2022.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Institucioni përbëhet nga organet drejtuese, rektorati, njësitë kryesore, njësitë bazë, njësitë ndihmëse mësimore dhe administrative, organet këshilluese dhe drejtuese, stafi akademik dhe administrata ( <i>rregulloja e UA</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Ky Fakultet përbëhet nga tre departamente:

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Departamenti i i Infermierisë dhe Fizioterapisë i cili ka 10 PAE, nga të cilët 3me grada/tituj;</li> <li>- Departamenti i Laborant Mjekesor dhe Imazheri, i cili ka 10 PAE, nga të cilët 3 me grada/tituj;</li> <li>- Qendra e Promovimit të Shëndetit i cili ka 7 PAE, nga të cilët 3 me grada/tituj;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, icili për vitin akademik 2019-2020 ka në përbërje gjithsej <b>28 personel akademik</b> nga ku <b>10 personel akademik efektiv (PAE)</b>, nga ku 3 me grada/tituj, dhe <b>18 personel akademik me kontrate (PAK)</b>,nga ku 10 me grada/tituj. (Ev 12, Tabelat 3)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Referuar RVB konstatohet se orët e praktikave mesimore në ateliere e infermieristikës organizohen dhe ndiqen nga stafi akademik me formim infermieror i departamentit, njësia nuk ka të angazhuar personel akademik ndihmës për realizim e këtyre praktikave.</p> <p><i>GVJ sugjeron në bazë të kërkesave të standartit të diferencohen në koncept orët e praktikave të cilat zhvillohen nga stafi akademik me funksionin e stafit ndihmës, akademik pranë laboratoreve dhe atelieve infermierore.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, përgjegjës për programin e studimit, bazuar në rregulloren e programit të studimit ka caktuar një person në rolin e Koordinatorit të Programit të Studimit, i cili mban përgjegjësi për ecurinë dhe zhvillimin e Programit dhe Praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. (Vendimet e dekanit, Vendim për përgjegjesit e programeve)</p> <p>Personi është staf akademik me kohë të plotë që ka formimin dhe kualifikimin e duhur për të kryer këtë funksion. Koordinator i programit dëshmon të raportojë në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton informacionet që lidhen me programin e studimit. (Raporti vjetor i infermierisë)</p> <p>Institucioni dëshmon angazhim të personelit mësimor-shkencor me kohë të plotë, për mbikëqyrjen e studentëve gjatë kryerjes së praktikës profesionale jashtë auditorit, dhe mirëmbajtjen e</p>




	<p>mjediseve laboratorike dhe shkollore. Kjo u konstatua gjatë vizitës në institucion të grupit të vlerësimit dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit shkresor.</p> <p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimit me stafin akademik vlerëson se, personeli akademik përmbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit sipas pozicionit të punës që kryhen dhe dëshmoi që ishte i angazhuar në përmbushjen e objektivave të programit.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në sistem, dhe vizitës në institucion ( <i>dosja e programit</i> ) konstaton se departamenti zotëron informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, programi i studimit është organizuar në lëndë, praktikë profesionale dhe aktivitete formuese.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit Msc në ‘Infermieri Klinike’ është i organizuar në lëndë dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në 2 (dy) vite akademike të ndara në 4 semestra.
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Organizimi i programit në bazë të veprimtarive formuese është bërë në përputhje me VKM 41/2018, duke ruajtur raportet e shpërndarjes në bazë të kategorive.  Në njësinë bazë ku zhvillohet programi i ciklit të dytë të studimit Msc në Infermieri Klinike, gjendet informacioni i nevojshëm lidhur me programin, ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit, mënyrën e vlerësimit të dijeve, detyrimet
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p>përfshihet informacioni i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>akademike, frekuentimin e programit, etj. (<i>Dokumentat e programit, Syllabuset e Moduleve</i>)</p> <p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitës në Institucion konstaton se IAL ka dhe vë në dispozicion të studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit. (<i>Procedurat e pranimit, Procedura e transferimit</i>)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Kriteret e pranimit, propozohen nga njesia baze /kryesore dhe aprovohen nga senati, përcaktimi i kriterëve të përgjithshme mbështetet në vendimet e MASR ndërsa ato specifike në bazë të rezultateve të studentëve në ciklin e parë të studimeve dhe në intervistën e cila zë 30% të vlerësimit. Programi Msc në Infermieri Klinike, akreditohet për herë të parë dhe që nga momenti i licensimit nuk ka bërë ndryshime në kurrikul, ndërsa përmbajtja e syllabuseve sipas RVB është në përditësim, <i>GVJ nuk mund të japë një vlerësim konkret pasi syllabuset janë shfrytëzuar vetëm gjatë një cikli studimi.</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit të syllabuseve konstaton:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Syllabuset janë hartuar në përputhje me VKM 41/2018;</li> <li>Diferencohet titullari i lëndës nga lektori, titullari është i kategorisë Profesor;</li> <li>Diferencohen qartë temat e leksioneve, të praktikave dhe seminareve, për çdo temë është vendosur numri i faqeve në literaturë;</li> <li>Një pjesë e madhe syllabuseve kanë si literaturë bazë skripte të pedagogëve, të cilat janë bazuar në literaturë të aprovuar nga Njësia Bazë. (<i>dokumentacioni i sjellë pas vizitës në IAL</i>)</li> </ol>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p><i>GVJ rekomandon, të përditësohet literatura në një pjesë të syllabuseve pasi është më e vjetër se 5 vjet;</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi II.4**

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Programi është në përputhje të plotë me nenin 75, pika 6 të Ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në bazë të kësaj pike përcaktohet se programet Master Shkencor organizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja e tyre është dy vite akademike. Programi i studimit është organizuar në leksione, seminare dhe praktika profesionale me ngarkesën përkatëse në kredite (<i>kurrikula e programit</i>). Në cdo semestër realizohen 15 javë mesimore me afersisht 25 orë mësimore në javë. Ndarja në kategori (A në E) dhe ngarkesa në kredite (në %) për veprimtaritë formuese përputhet me legjislacionin në fuqi VKM 41/2018.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Organizimi i programit është realizuar që të ketë një balancim midis formimit teorik dhe atij praktik, për arritjen e rezultateve të të nxënit, njohurive teorike bazë të profilit së studimit me qëllim punësimin e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Përmbajtja e çdo lënde të këtij mundëson marrjen e njohurive të plota në fushën e Infermierisë Klinike. Secila lëndë është strukturuar në mënyrë të atillë, që të ketë edhe praktikën të përfshira, për një përvetësim më të mirë të teorisë së trajtuar, në bazë të programit studenti ka mundësi të realizojë praktikën lëndore në atelietë infermierore pranë IAL dhe praktikën profesionale pranë Institucioneve Shëndetsore.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Organizimi i Programit të Studimit Master Profesional “Infermieri Kirurgjikale” bën grupimin e moduleve në lëndë, të shpërndarë në katër semestra akademik dhe 120 kredite, ku orët mësimore përcaktohen bazuar në kreditet e secilës lëndë.</p> <p>Struktura e programit është në përputhje me profilin e programit, dhe Institucioni deklaron se është bazuar në programe të ngjashme si Kurrikula e Masterit Shkencor të FSHMT, UMT. <i>Nuk ka evidencë që të vertojnë përdorimin e programeve ndërkombëtare si reference.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas</p>	<p>Organizimi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p>veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>ngarkesës mësimore ore/ETCS, ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale me qëllim rritjen e kapaciteve dhe cilesisë në shërbim të pacienteve.</p> <p>Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fusha të veçanta dhe të specializuara të infermieristikës të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. (<i>programi, rregullorja</i>)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Përmbajtja e programit i shërben studentëve për thellimin e njohurive të përfuara në ciklin e parë të studimit, shtimin dhe thellimin e njohurive në drejtime më të ngushta, specifike dhe shumë të specializuara. Ndarja në kategori e veprimtarive formuese dhe raportet e ngarkesës së tyre, bëjnë të mundur arritjen e objektivave të programit dhe zhvillimin e kompetencave të cilat i mundësojnë studentit vazhdimin e metejshëm të studimeve në cikle më të larta, programe të avancuar dhe specifike kualifikimi, dhe gjithashtu punësimin e tij në varësi të kërkesave të tregut të punës.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ nuk eidentoi ndryshime apo përditësime sistematike si të programit ashtu dhe të literaturës, dhe as komunikime me partnere apo bashkëpunëtorë nga tregu i punës. GVJ vlerëson që ky program është i ri dhe akreditohet për herë të parë.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Me njohuritë e marra në këtë program, studentët e ndjejnë veten të aftë në vendet e tyre të punës dhe dijet e marra janë në funksion të plotë të veprimtarisë së përditshme të tyre (<i>takimi me studentët</i>).</p> <p>Njohuritë e marra në këtë program dhe kurrikula e tij ju krijon jo vetëm mundësi punësimi studentëve në sektorin publik dhe privat, por gjithashtu krijon mundësinë e thellimit në drejtim akademik apo shkencor në ciklin e tretë të studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p><i>GVJ eidenton se asnjë nga studentet e këtij programi nuk ka qenë pjesë e ndonjë programi shkëmbimi apo mobiliteti panvarësisht se institucioni ka një sërë marrëveshesh bashkëpunimi.</i></p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor,</p>	

mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli akademik i angazhuar në programin Master i Shkencave në Infermieri Klinike, zotëron grada dhe tituj të ndryshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi duke patur ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve të caktuara.  GVJ nga shqyrtimi i CV-ve, vlerëson që stafi akademik përbëhet nga pedagogë me eksperiencë që kanë kualifikimin e duhur profesional, ata mbulojnë lëndë specifike konform specializimeve, kualifikimeve dhe fushave të tyre të ekspertizës. Një pjesë e mirë e pedagogëve të angazhuar kanë përvojë akademike dhe si mjekë klinikistë. Niveli i kualifikimit, ekspertiza dhe fusha akademike-kërkimore e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit përputhen me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve.  Stafi akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar për realizimin e programit të studimit për vitin akademik 2019-2020 zotëron tituj akademik dhe gradën shkencorë “Doktor i Shkencave”. Në disa prej moduleve ka të angazhuar edhe staf akademik me MSC se bashku me lektorin i cila është gjithmonë me gradën Doktor. ( <i>Evidenca. Ngarkesa e stafit e lidhur me programin mësimor</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	
<b>Kriteri 3.</b> Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme	Në evidencën e sipërcituar, në disa prej moduleve janë vendosur



<p>dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>emrat e dy pedagogeve dhe numri i krediteve të cilat mbulojnë është vënë i përbashkët, duke pasur mospërputhje me (<i>Evidenca nr 12, tabela nr 14</i>).</p> <p><i>Këto të dhëna i kanë krijuar paqartësi GVJ gjatë përlogaritjes së raporteve të ngarkesës mesimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar (<i>Evidences nr 12, tabelat 5 dhe 6</i>) numri dhe kualifikimi i stafit të angazhuar në këtë program studimi, për dy vite akademike është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik <b>2019-2020</b> personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është <b>23 pedagogë gjithsej</b>, nga të cilët <b>12</b> personel akademik efektiv (PAE), nga ku 8 me tituj/grada dhe 4 me Msc, dhe <b>11</b> pedagogë me kontratë (PAK), nga ku 10 me grada/tituj.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është <b>53% PAE</b>, ndërsa në bazë të krediteve stafi akademik efektiv mbulon <b>65.21 % të ngarkesës mesimore.</b></p> <p>Për vitin akademik <b>2018-2019</b> personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është <b>17 pedagogë gjithsej</b>, nga të cilët <b>5</b> personel akademik efektiv (PAE), nga ku 2 me tituj/grada dhe 3 me Msc, dhe <b>12</b> pedagogë me kontratë (PAK), nga ku 10 me grada/tituj.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është <b>30% PAE.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mesimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p><i>Nga sa më sipër GVJ rekomandon, që institucioni të marrë masa për rritjen në numër të stafit akademik, për të përmisuar mbulimin e ngarkesës mesimore në masën mbi 70% nga staf akademik efektiv (PAE), konform VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.</i></p> <p>Ngarkesa maksimale që mbulojnë pedagogët në Departament në orë mesimore nuk është më e lartë se ajo që parashikohet në vendimet e senatit (<i>Evidenca Vendim i senatit për ngarkesën mesimore të stafit akademik</i>). UA ka marrëveshje me institucione të tjera të arsimit të lartë të së njëjtës fushë, Institucione Universitare të Shërbimit Shëndetsor dhe aktorë biznesi në fushën e Shëndetsisë, të cilët në bazë të marrëveshjeve kanë vënë në dispozicion kapacitetet dhe personelin e tyre në funksion të udhëheqjes dhe mbikëqyrjes së studentëve në praktikën profesionale, punimit të diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit Msc në “Infermieri Klinike”. GVJ vlerëson që këto marrëveshje</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




	<p>bashkëpunimi janë shumë të rëndësishme dhe të vlefshme duke ndihmuar në realizimin e praktikës profesionale, punimet e diplomave etj.</p> <p><i>GVJ rekomandon të rritet numri i marrëveshjeve për të përballuar dhe asistuar në mënyrë më cilësore të gjithë studentet e këtij programi studimi, pasi janë të njëjtat institucione në të cilat realizohet praktika mesimore edhe për nivelet e tjera të studimit në degë Infermiore të këtij Institucioni. por edhe të një sërë institucionesh të tjera të arsimit të lartë publik dhe privat.</i></p> <p><i>Institucioni nuk ka angazhuar personel ndihmës mesimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mesimore, sipas natyrës specifike të programit.</i></p> <p>Në RVB deklarohet se këto funksione koordinohen nga stafi infermieristik i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Gjatë takimit me stafin akademik u konstatua se institucioni i kushton një vëmendje të rëndësishme hartimit dhe rishikimit të programeve të studimit në bashkëpunim të stafit akademik dhe institucionet bashkëpunuese me qëllim përshtatjen sa më të mirë me kërkesat e tregut të punës. (Ev 19. Raportet e takimeve Taix, UISH, FSHMT)
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të	Gjatë takimit me studentët, GVJ evidentoi që një pjesë e tyre punojnë si infermierë të licensuar dhe dijet e fituara në program i kanë shërbyer në punën e tyre të përditshme dhe rritjen e tyre profesionale.

<p>përmirësimin të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimin të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti Përgjegjës për programin e studimit, përmes koordinatores së programit, inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimin të Programit të Studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre duke realizuar takime dhe diskutime gjatë tërë vitit akademik. Studentët kanë një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e mënyrës së trajtimit të temave dhe përmirësimin të programit. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimin të Programit të Studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Drejtuesit dhe stafi u shprehën të hapur dhe të angazhuar në riorganizimin dhe përshtatjen e programit të studimit duke ju referuar dhe kërkesave të tregut të punës për infermier të profilizuar, në këtë kuadër Institucioni deklaroi rëndësinë e marrëveshjeve të bashkëpunimit në shkëmbimin e eksperiencave në lidhje me përmirësimin e programeve të studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.7</b></p>	
<p><b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Msc në Infermieri Klinike ka të përcaktuara qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit ku si objektivi kryesor citohet:</p> <p>Prodhimi i studiuesve të ardhshëm duke u dhënë mundësinë e avancimit drejt një karriere akademike dhe klinike, duke formuar gjithashtu infermierë të aftë për të menaxhuar situata komplekse klinike. Këto janë objektiva në përputhje të plotë me objektivat</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia</p>	

<p>kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>madhorë të institucionit.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë organizon, administron procesin akademik duke respektuar lirinë akademike të stafit në format e mesimdhënies, literaturën e përdorur, kërkimin shkencor etj. <i>(Rregullore e Departamentit)</i></p> <p>Në programin e studimit janë përfshirë module të cilat i ndihmojnë dhe i orientojnë studentët drejt kërkimit shkencor, realizimit të studimeve dhe projekteve, gjithashtu edhe në modulet e lëndëve klinike kanë të përfshira orë projektsh dhe detyrash me karakter kërkimor dhe studimor. <i>(Programi i studimit, Syllabuse e lëndëve)</i></p> <p>Studentet orientohen nga pedagoget drejt temave me rëndësi aktuale të shëndetit publik dhe të patologjive më të përhapura në nivel kombëtar. Aktivitetet kërkimore shkencore mbështeten krejtësisht nga instucioni. <i>(takimi me stafin, takimi me studentet)</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.8</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore</p>	<p>Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet universitare të shërbimit shëndetësor dhe laboratorët mësimore në institucion</p>

shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	krijojnë mundësinë e realizimit të projekteve të ndryshme kërkimore shkencore.			
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Departamenti demonstron angazhim të plotë në funksion të kërkesave të studenteve dhe personelit akademik duke siguruar kushtet dhe logjistikën e duhur materiale, laboratorike ashtu dhe njerëzore për realizimin e objektivave të programit.			
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	Institucioni realizon Konferencën e përvitëshme studentore dhe gjithashtu seminare e leksione të hapura, Departamenti nxit dhe mbështet pjesëmarrjen e studenteve në këto aktivitete, <i>por GVJ evidenton që studentët e këtij program studimi kanë vetëm pjesëmarrje pasive dhe jo aktive në këto aktivitete.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>Referuar RVB- së dhe takimit me drejtuesit e Institucionit, GVJ konstaton se Insitucioni i kushton një rëndësi të vecantë zhvillimit të metodave inovative në mësimdhënie duke u mbështetur në teknologjinë e informacionit dhe duke ndërthurur teorinë me demonstrime dhe aplikime klinike të realizuara pranë laboreve të infermieristikës (<i>vizita e ambjenteve</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ në takimin me stafin akademik konstatoi se në këtë program studimi zbatohen metoda inovative, platforma dhe sisteme që ndërthurin metodikën standarde të mësimdhënies me ato online. Në rregulloren e programit të studimit, përcaktohen elementët e mësimdhënies në programin e studimit, procesin e vlerësimit dhe testimit të njohurive, <i>por GVJ nuk ka në dispozicion udhëzues në nivel Institucional në lidhje me metodat inovative të mësimdhënies.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Për monitorimin e mësimdhënies dhe cilësisë së saj, institucioni ka në funksionim NJSBC e cila kryhen monitorimin në mënyrë periodike të personelit akademik dhe administrativ, ajo vlerëson në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike, për çdo semester, aftësitë e mësimdhënies dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik të brendshëm nëpërmjet formularëve të performancës dhe në mënyrë indirekte me anë të takimeve të vazhdueshme me studente dhe tutorët akademike. (<i>Rregullore e NjBSC</i>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Njësia monitoron dhe vlerëson në mënyre periodike procesin mësimor, aftësitë e stafit akademik bazuar në pyetëtorin e studentëve të cilin e organizon në fund të çdo semestri. Studentët shprehin vlerësimet e tyre për procesin e mësimdhënies, vlerësimin e tyre nga stafi akademik si dhe problematikat e ndryshme të hasura gjatë vitit akademik. (<i>Rregullore e NjBSC të, Pyetëtori i studentëve</i>) Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, dërgojnë rezultatet prane senatit akademik, dhe më tej bëjnë publike rezultatet e vlerësimit të pyetëtorit të kryer për çdo semestër akademik.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Rezultatet e përftuara i vihen në dispozicion strukturave vendimmarrëse të fakultetit, duke u përfshirë në pikëzimin e performancës akademike. Rezultatet dhe informacionet e marra</p>




	nga sondazhet i shërbejnë përmirësimit të punës në institucion dhe të stafit akademik, rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe zbatimit të metodologjisë bashkëkohore në formimin e studentëve. (Ev 22. Formulari i performancës akademike)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në realizimin e procesit mësimor UA përdor metoda të ndryshme mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve si leksione, seminare, praktika profesionale, detyra kursi, projekte/detyra kursi individuale dhe/ose në grup, provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare. [ <i>Programi mësimor, takimi me tafin akademik</i> ].  Gjatë mësimdhënies përdoren metoda alternative si prezantime në poë er point, biseda interaktive me studentët apo temave të vecanta nga studentët dhe diskutimi i tyre, diskutime dhe zgjidhje të rasteve klinike. Stafi akademik asiston apo ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të mësimin apo praktikës mësimore. ( <i>takimi me stafin</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Personeli akademik merr parasysh kërkesat dhe sugjerimet e studentit për zhvillimin më efektiv dhe cilësor të mësimin leksione apo seminare për ti bërë ato më efektive dhe tërheqës për studentët. [ <i>takimi me studentin dhe stafin</i> ].  Institucioni ka siguruar infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor të cilat bëjnë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre ne funksion të formimit të tyre profesional në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Institucioni ka vënë në dispozicion platformën google classroom, në të cilën pedagogët publikojnë
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

<p>didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>materiale, leksione, video mesimore.</p> <p>Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, duke nxitur dhe mbështetur stafin në përdorimin dhe aplikimin e metodave të ndryshme didaktike, me synim rritjen dhe përmirësimin e proceseve dhe produkteve të mësimdhënies-nxënies.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilin.</p>	<p>Referuar edhe CV-ve të stafit akademik të administruara në paketën e dokumentacionit dorëzuar nga UA, konstatohet se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka formimin e duhur bazë dhe të avancuar për të qenë pjesë akademike e programit. Studentët përfshihen aktivisht në procesin e mesimdhënies sidomos në orët praktike dhe modulët e inferrmieristikes, duke zgjidhur raste klinike e shkëmbyer eksperiencia. (takimi me stafin,takimi me studenët)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni vlerëson në mënyrë periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimin të pyetësorit të vlerësimit. <i>[pyetësore për studentët]</i>. Gjatë plotësimin të formularëve të vlerësimit japin mendimin e tyre mbi metodat interaktive të zhvillimit të mësimin për çdo lektor.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Për të inkurajuar sensin e autonomisë së studentëve, metodat e mësimdhënies ndërthuren me diskutimet, punën në grup, pjesmarrje në aktivite të ndryshme shkencore me qëllim ndërtimin e marrëdhëniesve të shëndetshme ndërmjet tyre. <i>(takimi me studentët)</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studentin, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhëniesve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



**profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Nga vizita në institucion u konstatua që e gjithë infrastruktura e cila ishte në funksion jo vetëm të procesit mësimor, plotësonte të gjitha standardet. Institucioni ka siguruar hapësira të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor si: Laboratore, auditore, zyra, klasa, të cilat janë të mjaftueshme, të pastra dhe të mirëmbajtura, dhe me ndriçimin e duhur, [ <i>infrastruktura</i> ]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Ambientet ku zhvillohej procesi mësimor kishin logjistikën e nevojshme, sallat e leksioneve ishin të pajisura me kompjutera dhe projektorë, dhe të seminareve me tabela shkrimi të cilat ndikojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies. [ <i>evd. Planimetria e FSHMT</i> ], [ <i>vizita e ambienteve</i> ]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik u deklarua se ata kanë mundësi të shfrytëzojnë burime të ndryshme informatike, përmes infrastrukturës IT. Laboratorët janë të paisur me të gjithë aparataturat edhe mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor, detyrave të kurrsit, diplomave apo studimeve specifike, gjatë takimit me studentët GVJ evidentoi që koto mjedise shfrytëzohen vashdimisht nga studentët. Rrjeti kompjuterik shtrihet në të gjithë godinën dhe i gjithë stafi ka adresë të brendshme të email të aksesueshme brenga dhe jashtë Institucionit. Të gjithë studentët e UA kanë adresa të brendshme emaili ma anë të të cilëve aksesojnë të dhenat personale, rezultatet e provimeve dhe informacione të tjera didaktike. Në funksion të studentëve është edhe portali i studentit i cili është i aksesueshm nga të gjithë llojet e pajisjeve elektronke. Në fund të çdo syllabusi studenti gjen informacion lidhur me literaturën që mund të konsultojnë në gjuhën shqipe apo të huaj që i përgjigjet temave të programit mësimor [ <i>format syllabusi</i> ].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p><i>Literatura e detyruar vënë në dispozicion të studentëve në një pjesë të syllabuseve rezulton se është më e vjetër se pesë viteve të fundit.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Gjatë takimit me studentet dhe shqyrtimit të syllabuseve GVJ evidenton që studentet kryesisht marrin literaturë të printuar, të përpunuar nga pedagogu i lëndës të cilat nuk ndodhen në ndonjë</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli</p>	




akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	sistem online apo në bibliotekë në formë hard copy. ( <i>takimi me studentet, syllabuset 2018-2019</i> ).			
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	GVJ vlerëson që shfrytësimi i literaturës bashkohore është në nivele jo të kënaqëshme nga studentët, megjithë kushtet optimale të siguruara nga institucioni.			
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Institucioni i siguron studentëve dhe pedagogëve mundësi aksesimi në dy biblioteka, si burim informacioni sipas programit të studimit që ata frekuentojnë, në këto biblioteka ofrohen rreth 14 mijë tituj të klasifikuara dhe të informatizuara, 60 poste leximi dhe 25 poste interneti. Në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve gjithashtu është edhe biblioteka online “Hinari”. IAL deklaron se ka pasur bibliotekën me 20 mijë libra të rinj dhe do të jëtë funksionale në kampusin e ri universitar. ( <i>RVB, takimi me stafin</i> )			
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Institucioni ofron platformën on-line FxEdukation (elearning), platformë në të cilën studentët me anë të hapësirës vetjake të dedikuar marrin informacion për të gjithë elementët e jetës së tyre akademike. Temat e diplomës zgjidhen nga studentët në konsultim me pedagogët e tyre në mënyrë që temat e tyre të jenë të lidhura me problematikat aktuale të sistemit shëndetësor, të jenë në funksion të përgatitjes së tyre profesionale dhe mundësive aktuale për realizimin e pjesës eksperimentale të tyre. Institucioni ka të përcaktuar formatin e diplomës, formularin e aplikimit, udhezimin për modalitetin e diplomës. Pedagogët udhëheqës asistojnë në të gjitha etapat e procesit të realizimit të diplomës. ( <i>RVB, Takimi me studentët</i> )			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni ka të organizuar me akte rregullatore mënyrën e funksionimit të UAL/Fakulteteve/departamenteve të cilat janë në funksion të organizmit të mësimdhënies në programe të ndryshme që ka UA. Institucioni ka ngritur NJSBC e cila është përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional. <i>[rregullore NJSBC]</i>. Kjo njësi harton plan pune përgatit raporte vlerësimi dhe analizon rezultate. NJSBC në mënyrë periodike bën vlerësimin e syllabuseve, literaturës, provimeve dhe jep rekomandimet e nevojshme për përmirësim <i>[formulari vlerësimit]</i>. Në kuadër të rritjes së cilësisë, shërbejnë dhe trajnimet, konferencat, dhe veprimtari të tjera shkencore për nxitjen dhe zhvillimin e aftësive dhe kompetencave të stafit në metodat e reja të mësimdhënies-nxënie</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë është njësi përgjegjëse për realizimin e procesit mësimor dhe përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së tyre dhe përmirësimin e programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni deklaron që Stafi akademik i Fakultetit të Shkencave Mjeksore Teknike, përfshihet në mënyrë të vazhdueshme në mobilitete për mësimdhënie brenda dhe jashtë vendit, <i>por GVJ nuk gjeti dokumentacione të cilat mbështesin mobilitetin e stafit përgjegjës për këtë program studimi.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ identifikoi se Institucioni mbështet angazhimin e personelit akademik në fushën e kërkimit shkencor duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në aktivitete shkencore, <i>por GVJ rekomandon shtimin në sasi dhe cilesi të këtyre aktiviteve kryesisht të dedikuara në fushën e infermieristikës.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni demostroi organizimin e aktiviteteve të cilat trajnojnë personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. <i>(Ev Tabelat ,Tabela 18)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe</p>	<p><i>GVJ rekomandon, rritjen e numrit dhe cilësinë e aktiviteteve shkencore, informuese dhe trajnuese, aktivitete të cilat të nxisin shkëmbimin e eksperiencës dhe shpërndarjen e informacionit, në funksion të rritjes së nivelit shkencor dhe pedagogjik të stafit akademik.</i></p> <p>Personeli akademik i Departamentit tenton të aplikojë dhe</p>




implementimin e metodave të reja.	testojë vazhdimisht teknika të reja të mësimdhënies ku përfshihet përdorimi i teknologjisë apo i mjeteve të tjera didaktike, ai ndan eksperiencat dhe raporton periodikisht të dhëna të cilat përfshihen në analizën vjetore të njësisë kryesore. (ev 27. Analiza vjetore e FSHMT)			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Institucioni ofron mobilitete për mësimdhënie dhe kërkime shkencore për stafin akademik dhe administrativ kryesisht në universitetet europiane me të cilat UAL ka lidhur marrëveshje , por GVJ evidenton se nuk ka asnjë rast mobiliteti të stafit akademik, nga ose drejt institucionet bashkëpunuese në Departamentin i cili ofron programin e studimit MSC në Infermieri Klinike			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni zotëron të gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve. Të gjitha procedurat evidentohen në Rregulloren e Departamentit dhe Rregulloren e Sekretarisë.  Të gjitha procedurat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik, ku lektori i cdo lëndë u shpjegon studentëve syllabuset, rregullat e provimit, mënyrën e vlerësimit dhe përqindja përkatëse në frekuentim, aktivizim gjatë gjithë
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	semestrit dhe prezantimin e mbrojtjes të detyrës së kursit ( <i>Rregullore e Departamentit, Syllabuset</i> )			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	<p>Kontrolli i dijeve në programin Msc Infermieri Klinike, bëhet në mënyrë të vazhdueshme, në një pjesë të moduleve ai realizohet përmes provimeve me shkrim, i ndërmjetëm dhe përfundimtar ku studenti përfiton pikë, të cilat mblidhen dhe përkthehen në notë, sipas një tabelë të njësuar konvertimi, pikëve të provimit u shtohen edhe ato të vlerësimit bazuar në detyrat e kursit, projekte individualë apo në grupe, gjithashtu studentët vlerësohen edhe për praktikën profesionale. Në një pjesë të moduleve vlerësimi gjatë vitit bëhet vetëm në bazë të aktivizimit, frekuentimit, detyrave të kursit, projekteve. Kjo mënyrë vlerësimi i jep studentit mundësi të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. (<i>Rregullore e Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore, Model Syllabusi, Vendim I senatit për pikëzimin e vlerësimit.</i>)</p> <p>Studentët informohen nga titullari i lëndës/modulit me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në fillim të çdo viti akademik apo lëndëve të veçanta të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe rregulloren e funksionimit të Fakultetit të Shkencave Teknike Mjekësore.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Kontrolli i dijeve në programin Msc në Infermieri Klinike bëhet në mënyrë të vazhdueshme, IAL përdor elementë të ndryshëm vlerësimi me pesha të ndryshme në module të ndryshme, në varesi të numrit të kredive dhe shtrirje në semestra. Në një pjesë të moduleve ai realizohet përmes provimeve me shkrim, i ndërmjetëm dhe përfundimtar ku studenti përfiton pikë, të cilat mblidhen dhe përkthehen në notë, sipas një table të njësuar
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	konvertimi, pikëve të provimit u shtohen edhe ato të vlerësimit bazuar në detyrat e kursit, projekte individuale apo në grupe, gjithashtu studentët vlerësohen edhe për praktikën profesionale. Në një pjesë të moduleve vlerësimi gjatë vitit bëhet vetëm në bazë të aktivizimit, frekuentimit, detyrave të kursit, projekteve. Kjo mënyrë vlerësimi i jep studentit mundësi të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara, dhe i motivon studentet për punë sistematike gjatë tërë vitit. <i>(Rregullore e Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore, Model Syllabusi, Vendim i senatit për pikëzimin e vlerësimit.)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Shkalla e përvetësimit të dijeve dhe aftësive profesionale me shkrim dhe / ose me gojë ose me temë diplome sipas rregulloreve të funksionimit të programit dhe në përputhje me specifikën e lëndës bëhet në bazë pikëzimi 0-1000 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 deri në 10. Në bazë të përqindjes si më poshtë:
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nota 4 0-40%</li> <li>- Nota 5 41-50%</li> <li>- Nota 6 51-60%</li> <li>- Nota 7 61-70%</li> <li>- Nota 8 71-80%</li> <li>- Nota 9 81-90%</li> <li>- Nota 10 91-100%</li> </ul>
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<i>Institucioni nuk zbaton sisteme elektronike të kontrollit të dijeve, përveçse në lëndën e Informatikës, ky fakt kushtëzohet nga specifika e lëndëve mjekësore të cilat kanë qëllim të bëjnë vlerësimin e pacientit, diagnozën trajtimin dhe ku metoda e provime me shkrim, me zgjidhje rastesh apo pyetje të hapura është ajo e duhura.</i>
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Mënyra dhe sistemi i vlerësimit ju komunikohen studentëve në fillim të procesit mësimor. Në provim janë të pranishëm personeli akademik i lëndës (lektori dhe asistent-lektori i lëndës) ose personeli akademik i lëndës dhe personeli akademik asistues i caktuar nga Përgjegjësi i Departamentit <i>(Rregullore e sekretarisë)</i> . GVJ nga verifikimi me sondazh i fletëve të provimit konstatoi se fletet e provimit firmosen nga sekretari, dekani, dhe
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas	

përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	dy pedagogë të lëndës.			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	IAL përdor sistem kodifikimi duke siguruar anonimin gjatë korigjimit të provimeve, procesi i kodimit realizohet nga sekretaria dhe pas ckodimit pikët e marra nga studenti mblidhen më pikët e marra nga studenti nga format e tjera të vlerësimit.			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	Bazuar në rregulloren e Njesisë Kryesore, dhe gjatë takimit me stafin evidentohet që gjatë provimit:			
	<ul style="list-style-type: none"> <li>- nuk lejohet komunikimi me asnjë person tjetër përveçse me personelin akademik të kursit;</li> <li>- nuk lejohet përdorimi i celularit apo i çdo mjeti tjetër komunikimi ose regjistrimi;</li> <li>- nuk lejohet përdorimi i asnjë materiali mësimor përveç materialeve të lejuara nga personeli akademik i kursit;</li> <li>- përvec survejimit nga personeli akademik institucioni ka siguruar gjithashtu monitorimin me kamera gjatë zhvillimit të provimeve;</li> </ul>			
	<i>UAL nuk përdor programe për të evituar plagjaturën e eseve dhe temave të diplomës.</i>			
	Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente. Lektor i lëndës, në orën pasardhëse të provimit, trajton tezën e provimit për studentët duke bërë ballafaqimin e rezultateve, për të siguruar transparencën në vlerësim. <i>(Rregullore e programit)</i>			
	Rezultatet e kontrollit të dijeve bazohen mbi meritokracinë, e studenteve rezultatet ju komunikohen në orën pasardhëse (java vijuese) pas kryerjes së provimeve të ndërmjetme dhe jo me vonë se 7 ditë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar. <i>(Rregullore e sekretarisë)</i>			
	Studenteve iu garantohet e drejta e ankimimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin.			
	Kërkesat për rishikim mblidhen dhe shqyrtohen nga Drejtuesi i Departamentit, dhe kërkon rimarrje të studentit në provim nga një komision i posatshëm. Pedagogu dhe studenti janë të pranishëm në këtë proces.			
<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Nuk</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>




standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit të ciklit të dytë Msc në Infermieri Klinike realizohet në 2 vite akademike, 4 semestra dhe ka 120 ECTS në total. Një vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor të ndarë në dy semestra. Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor. 1 orë mësimore – 50 minuta.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit. Procesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, apo prezantime orë praktike, orë individuale  Në këtë program studimi ofrohen lëndë, module apo leksione të cilat garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit sic janë: “Informatika Mjeksore”, “Anglishte Teknike”, “Psikologji Klinike”, “Shkrim Akademik” ( <i>programi i studimit, syllabuset</i> )
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Masteri i shkencave në Infermieri Klinike synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara në profilin përkatës dhe të formojë infermierë me kompetencën e nevojshme profesionale teorike dhe praktike në të gjitha Specialitet Klinike.
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Stafi akademik paraqitet i përkushtuar të realizojë të gjithë objektivat mësimore dhe formuese. Në përfundim të lëndës pedagogu bën një përmbledhje të tematikavë të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme orën e fundit të mësimin, pedagogu si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Gjithashtu pedagogu ndalet në vecanti në temat më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Pedagogë bëjnë vlerësim të vazhdueshëm dhe dinamik të
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)






të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	lëndës përmes provimeve të ndërmjetëme, detyrave të kursit dhe pjesëmarrjes aktive gjatë procesit mësimor.			
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore institucioni organizon leksione të hapura, jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kanë mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet tyre. (Tabelat, Tabela 19)			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Personeli akademik i Departamentit ka realizuar veprimtari të ndryshme, me stafin, të ftuar dhe studentët, në formën e: leksioneve të hapura nga përfaqësues të institucioneve/subjekteve të ndryshme të ftuar në auditor ose jashtë tij; vizita mësimore pranë institucioneve/subjekteve të ndryshme.			
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	<i>GVJ vlerëson se numri dhe cilësia e këtyre aktiviteteve duhet të rritet në funksion të rritjes profesionale shkencore të stafit dhe cilësisë së mësimdhënies.</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Gjatë takimit me stafin akademik u vu re se ata ishin të hapur dhe mbështetnin diskutimet, punën në grup me zgjidhjen dhe adresimin e problematikave të vecanta, gjithashtu stafi u paraqit me një klimë shumë ambicioze dhe i etur për zhvillimin e ideve inovative, studimeve të avancuara shkencore etj. Institucion përpiqet të mbështesë stafin në nxitjen e këtyre ideve, në një frymë shumë pozitive.			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	GVJ duke u referuar lëndëve të zhvilluara dhe CV-ve të stafit akademik, konstatoi se fusha e ekspertizës së pedagogut përputhet me syllabusin e lëndës të cilën zhvillon pedagogu duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e mësimdhënies. Profili i stafit akademik ku një pjesë e mirë janë mjekë klinikistë të lidhur direkt me pacientin dhe klinikën, gjithashtu përmbajtja e syllabuseve dhe realizimi i praktikës profesionale pranë Institucioneve Shëndetsore Universitare, u krijon studenteve mundësinë e zhvillimit të kompetencave direkt në praktikë .			
	<i>GVJ vë re se deri më tani asnjë pjesëtar i stafit akademik apo student nuk ka përfituar nga programet e mobilitetit të mbështetura nga Erasmus .</i>			
<b>aShkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

				<b>X</b>
--	--	--	--	----------

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Studenti në fund të studimeve pajiset me diplome Msc në Infermieri Klinike, pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur mikrotezën. Rregullorja e punimit të temës së diplomës mbart informacion të detajuar për mënyrën organizimit dhe shkrimit. Procedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bazohet në rregulloren e UA dhe të programit të studimit. ( <i>Ev. 26 Diploma. Udhezim</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë asiston studentët me informacione, udhëzime e materiale të ndryshme. Departamenti përcakton përcakton udhëheqësit shkencor për diplomantët, sipas fushës së ekspertizës dhe miraton temën e diplomës, përveç udhëheqësist shkencor studentët asistohen edhe nga një pedagog infermier gjatë mbledhjes, seleksionimit dhe përpunimit të të dhënave. Fokusi i programit Msc në Infermieri Klinike, është përvetësimi i aftësive teorike dhe praktike profesionale nga ana e studentit. Bazuar në këtë qëllim zgjedhja dhe përpunimi i temës së diplomës si detyrim përmbyllës, synon të testojë aftësitë e studentëve për të aplikuar njohuritë e përfituara në programin e studimit në përgatitjen e një teme studimore. Moduli i “Metodologjisë së kërkimit shkencor” i ndihmon studentët të realizojnë një punim shkencor me synim arritjen e qëllimit të programit të studimit. Udhëheqësi shkencor siguron që studentit të marrë mbështetjen dhe udhëzimet e nevojshme për të kryer punë kërkimore të suksesshme individuale.
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Provimi i përgjithshëm përfundimtar është konceptuar si përmbledhje dhe eksplorim i njohurive të dhëna gjatë tërë periudhes së studimit dhe duke e organizuar në varësi të peshës specifike të lëndëve dhe moduleve. Departamenti i cili mbulon programin e studimit i siguron studentit dhe pedagogut udhëheqës

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>të gjitha lehtësirat dhe vë në dispozicion së bashku me partnerët bashkëpunues mjediset dhe mjetet e nevojshme për realizimin e pjesës eksperimentale të temës së diplomës me qëllim mbledhjen, evidentimin dhe përpunimin e të dhënave të nevojshme. Në realizimin e temës së diplomës studentët asistohen në mënyrë të vazhduar nga pedagogët, ndihma e të cilëve konsiston në hartimin e strukturës së temës, zgjedhjen e literaturës, metodologjisë së shkrimit apo prezantimit të studimit. Në fund është udhëheqësi ai që aprovon paraqitjen e temës para komisionit. <i>(takimi me studentët)</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Mbrojtja e temës së diplomës bëhet përpara komisionit të propozuar nga departamenti dhe miratuar nga Dekani i fakultetit. Provimi përfundimtar dhe punimi i diplomës vlerësohen me notë, nga një Komisioni i përbërë nga lektorë të Departamentit.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj institucionit dhe ka përmbyshur detyrimet përmbyllëse të programit të studimit, pajiset nga institucioni me diplomën përkatëse, të shoqëruar me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve universitare në UAL me suplementin e diplomës, të firmosura nga Dekani.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Dokumentacioni lidhur me studentin ruhet nga institucioni për një afat kohor 5 vjeçar dhe mund të japi informacion për studentët nëse kërkohet. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se në Zyrën e Burimeve Njerëzore ruhen dosjet dhe dokumentacioni me të dhënat për personelin akademik me kohë të plotë, si dhe atij me kontratë, po ashtu edhe të personelit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Zyra menaxhon dhe përditëson të dhënat elektronike.</p> <p>Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik, ndihmës dhe administrativ (<i>Evidencë 12: Tabelat, tabela 5,6</i>). Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore u përzgjedhën dy dosje në mënyrë rastësore, një nga personeli akademik dhe tjetra nga administrata, të cilat rezultuan të kompletuara konform rregullave dhe kriterëve institucionale.</p> <p>Rekrutimi i punonjësve bazohet në dokumentat rregullatorë të institucionit dhe në procedurën e rekrutimit. (<i>Evidencë 28: Procedura e rekrutimit.</i>) në përputhje me nevojat e UA për staf akademik, staf ndihmës akademik, duke u bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Planet mësimore dhe planifikimin e stafit akademik përkatës;</li> <li>• Realizimin e ngarkesave mësimore;</li> <li>• Përbushjen e kriterëve ligjore të structures;</li> </ul> <p>Referuar RVB-së dhe vizitës në Institucion, Departamenti i propozon Dekanit pozicionet e lira si dhe kriteret specifike dhe dokumentet kryesore që duhet të dorëzojë kandidati. Dekani ngre komisionin e rekrutimit me rreth 4-5 veta, ku të paktën 3 janë anëtarë të departamentit. UA shpall njoftimin për vend të lirë pune dhe afatin e dorëzimit të dosjeve të kandidatëve. Komisioni i rekrutimit shqyrton dosjet sipas një sistemi pikëzimi të miratuar më parë nga senati akademik. Kandidatët klasifikohen sipas pikëve të fituara dhe komisioni shpall fituesin, mandej ia dërgon për miratim titullarit të njësisë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	kryesore dhe senatit akademik. Rektori emëron kandidatin fitues me një urdhër të brendshëm. Punëdhënësi dhe punëmarrësi lidhin kontratën e cila depozitohet në Zyrën e Burimeve Njerëzore në dosjen personale të punëmarrësit. (Evidencë 28. Procedura e rekrutimit).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësues-shkencor.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se personelit i krijohen kushte të përshtatshme pune në një mjedis bashkëveprues tepër pozitiv për realizimin e procesit akademik. Institucioni angazhohet dhe lehtëson kualifikimin e vazhdueshëm të stafit nëpërmjet marrëveshjeve me institucione akademike të fushës, si dhe përfshirjes në projekte si CEPUS dhe ERASMUS +. Nuk ka evidencë për kualifikimin e stafit që administron programin.</p> <p><i>GVJ sygjeron, fokusimin e institucionit në drejtim të stafit infermier për marrjen e titujve dhe gradave shkencore. Ky është edhe një shqetësim i pedagogëve infermierë (Takimi me stafin).</i></p> <p>Institucioni organizon në vazhdimësi trajnime pedagogjike në lidhje me metodat gjatë mësimdhënies, me njohjen e diversitetit psikologjik të studentëve dhe përmirësimin e komunikimit në procesin e mësimdhënies. (Evidenca 12, Tabelat, tabela 18)</p> <p>Nga gjithë sa janë dokumentuar më sipër sa i përket angazhimit të burimeve njerëzore, Institucioni dëshmon korrektësi dhe angazhim të vazhdueshëm në arritjen e objektivave të programit të studimit (Takimi me stafin).</p>

<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit,</p>	<p>Referuar RVB-së, Universiteti Aldent ka në dispozicion të procesit mësimor një sipërfaqe 8700m<sup>2</sup>. Për FSHMT vihet në përdorim një sipërfaqe rreth 5000m<sup>2</sup>, ku përfshihen salla leksionesh e seminaresh me kapacitet 30 deri 120 studentë, laboratorë, zyra të stafit e personelit. Është duke përfunduar godina e re e UAL e cila, është konceptuar si një kampus modern universitar, me standarte të larta logjistike (<i>Evidencë 23, 24: Planimetria e godinës së FSHMT dhe kampusit të ri</i>).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se sallat e leksioneve dhe seminareve ishin të pajisura me video-projektorë, kompjutera të lidhur me internet dhe tabela. Ndricimi natyral dhe artificial ishte i përshtatshëm. Dritaret janë me grila ose perde për të lejuar pamje të qartë gjatë projeksonit. Laboratorët janë të mirëpajisur me materiale, mulazhe, aparatura e mjete të nevojshme për aplikimin e procedurave infermierore.</p> <p>Institucioni ka siguruar një laborator informatike në të cilin zhvillohen lëndët e informatikës dhe statistikës. Në këtë laborator zhvillohen programet bazë kompjuterike, përpunimet statistikore si dhe të kërkimit shkencor.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

<p>përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimi teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje të posaçme bashkëpunimi me institucione të tjera të shëndetit, në të cilat zhvillohen praktikat klinike të domosdoshme për realizimin e programit. <i>(Evidencë 5: Marrëveshjet, marrëveshjet me spitalet).</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e</p>	<p>Institucioni ve në dispozicion të studentëve dy biblioteka mësimore me dy salla leximi të pajisura me vende leximi dhe internet. <i>(Biblioteka e FSHMT).</i></p> <p>Referuar RVB-së, biblioteka përmban rreth 13 mijë e pesëqind tituj librash në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj të klasifikuar sipas profileve dhe disiplinave. Në bibliotekën e FSHMT ka</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p>programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>rreth 5 mijë libra në dispozicion. Ajo pasurohet në mënyrë periodike me botime revista shkencore, libra etj. Fondi i librave është pasuruar së fundmi edhe me 20 mijë tituj të rinj librash që do të skedohen në kampusin e ri universitar (<i>Evidencë 25: Biblioteka, Dokument për librat nga USA</i>). Nuk ka të dhëna mbi efikasitetin e përdorimit të bibliotekës, ndërkohë që literatura bazë–dispencat menaxhohen nga sekretaria mësimore (<i>Takim me stafin</i>).</p> <p>UAL ka disa vjet që ve në dispozicion edhe bibliotekën on-line “Hinari” bibliotekë e OBSH. Kompjuterat e instaluar në ambjentet e bibliotekës ofrojnë akses pa kufizim interneti. Për materialet e bibliotekës ekziston edhe katalogu elektronik.</p> <p>Bazuar në kërkesat e departamentit, institucioni akordon cdo vit një fond të posacëm për pasurimin e literaturës në bibliotekë me libra apo traktate mjeksore. Ambjentet e bibliotekës vihen në dispozicion të studentëve në përputhje me nevojat e tyre, në përshtatje të orarit mësimor. Kapaciteti i bibliotekës është i mjaftueshëm për përdorimin e saj nga një numër i konsiderueshëm studentësh njëkohësisht.</p> <p>GVJ vlerëson që shfrytësimi i literaturës bashkohore është në nivele jo të kënaqshme nga studentët, megjithë kushtet optimale të siguruara nga institucioni. Shfrytëzimi i ulët i literaturës së huaj në bibliotekat online, konsiderohet si pikë e dobët edhe në RVB.</p> <p><i>Eshtë nonsens që studentët e masterit shkencor, studiues të fushës dhe kërkues të ardhshëm të qëndrojnë larg bibliotekës dhe të jenë të painteresuar për literaturën bashkohore dhe hulumtimin shkencor, ndërkohe që zhvillojnë në kurrikul lëndë të kërkimit shkencor dhe përgatiten për studime të thelluara në fushën e infermierisë klinike.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që institucioni të inkurajojë përdorimin e bibliotekës, të ketë përputhje të literaturës të rekomanduar në syllabuse, detyra kursi, tema studimore dhe diplom, me literaturën e bibliotekës dhe të nxiten studentët në përdorimin e bibliotekës online në shqip dhe gjuhë të huaja.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>



			X	
--	--	--	---	--

### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë</p>	<p>Sistemi i menaxhimit në UA përfshin sekretarinë mësimore dhe sistemin dixhital. Cdo anëtar i stafit dhe cdo student ka adresën e vet të e-mailit, të cilën mund ta aksesojë në cdo kohë brenda dhe jashtë universitetit. Nëpërmjet faqes ë eb ual.edu.al studentët aksesojnë të dhënat personale, rezultatet e provimeve sipas semestrave apo viteve akademike, si dhe të dhëna të tjera didaktike.</p> <p>Fx Education është një platformë ku koordinohen të dhënat e sekretarisë mësimore, stafit akademik dhe studentëve me akses të përcaktuar ndaj nevojave dhe detyrimeve përkatëse. Kjo platformë siguron akses të dedikuar në informacione dhe dokumente si për personelin, ashtu edhe për studentët e programit të studimit. (<i>Evidencë 29: Manual përdorimi Fx Education</i>).</p> <p>Nëpërmjet Google Clasroom, pedagogët dhe studentët mund të komunikojnë në grup ose individualisht, të përcjellin materialet e modulit, linke, të vendosin deadline, të kontrollojnë projektet apo të diskutojnë virtualisht mbi modulën mësimor. Programi Fx Education garanton në kohë reale përcjelljen e informacionit të aksesueshëm sipas kategorive në sekretaritë mësimore, përgjegjës programi, titullari, staf akademik dhe studentë.</p> <p>Faqja zyrtare e UAL është aktive në dy, gjuhë shqip dhe anglisht, nëpërmjet saj studentët dhe të interesuarit mund të hyjnë lehtësisht dhe të gjejnë informacione mbi programet dhe aktivitetin akademik të UA.</p>

<p>reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e</p>	<p>Në RVB citohet se, që në momentin e planifikimit të celjes së programit të studimit, institucioni bën një parashikim të kostove dhe mundësive të mbështetjes financiare, me synim plotësimin e kushteve infrastrukturore dhe akademike për zhvillimin normal të procesit mësimor.</p> <p>Plani i financimit përshkruan të gjitha kostot e një programi studimi. Ai përmban financimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturore, pajisjet, materialet e konsumit për zhvillimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore e spitalore, fondin për pasurimin e bibliotekës dhe aksesin në bibliotekat on-line, kostot e auditeve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe mundësitë e mbështetjes financiare të projekteve të UA. (<i>Evidencë 30. Plani i biznesit të UAL</i>).</p> <p>Cdo fund viti akademik hartohen pasqyrat financiare, ku përcaktohet gjëndja financiare dhe realizimi i Projekt - Buxhetit</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p>literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>të UAL. Institucioni kryen cdo vit auditimin edhe pse, duke qënë një institucion jo publik trajtohet si biznes me të drejtat dhe detyrimet ndaj punonjësve, studentëve dhe shtetit.</p> <p>Cdo vit institucioni përpilon pasqyrat financiare:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pasqyra e pozicionit financiar (Bilanci kontabël);</li> <li>• Pasqyra e performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve);</li> <li>• Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare;</li> <li>• Pasqyra e Ndryshimit të Kapitalit Neto (Evidencë 12: Tabelat, tabela 20);</li> </ul> <p>Nga raportet financiare të UA dëshmohet se, institucioni ka një gjëndje të qëndrueshme financiare dhe rritje ekonomike nga viti në vit, pa detyrime ndaj të tretëve individë, organizata, banka apo organe tatimore. Rritja ekonomike, citohet në RVB, i ka shërbyer rritjes së cilësisë, shtimit të laboratorëve dhe përmirësimit të infrastrukturës së UA, duke qënë një garanci për të ardhmen.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Nuk</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>




standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të</p>	<p>Institucioni garanton nëpërmjet statutit të Universitetit “Aldent” dhe Rregulloreve të institucionit, zbatimin e politikave dhe procedurave në përputhje me legjislacionin në fuqi. (<i>Evidenca 1: Statuti I Universitetit “Aldent” pjesa e tetë</i>), (<i>Evidenca 3: Rregullore e UAL – Kreu XIII</i>).</p> <p>Prej tyre vijon zbatimi i ligjit në Rregulloren e FSHMT, Rregulloren e Departamentit Infermieri dhe Fizioterapi, Rregulloren e Programit.</p> <p>Rregullorja e programit përcakton me ligj procedurën e pranimit, të drejtat dhe detyrimet e studentit, diplomimin, duke hartuar politika që garantojnë barazinë e studentëve.</p> <p>Bazuar në kriteret kombëtare dhe propozimit të ardhur nga njësi bazë me vendim senati shpallen kriteret dhe modalitetet e pranimit të studentëve, të cilat u bëhen me dije aplikantëve përgjatë periudhës së informimit. Pranimi i studentëve bazohet në kriterin e mesatares së programit të studimit të nivelit të parë dhe intervistës në institucion, duke respektuar renditjen sipas pikëzimit. (<i>Evidencë 14. Procedura e pranimit të studentëve 19-20, Takim me GVB, Takim me studentët</i>).</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

<p>dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p><i>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sekretari, përkatsisht dosjeve të studenteve, GVJ evidentoi që mungonin diplomat e mbrojtjes së gjuhës së huaj, duke mos përmbushur kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve bazuar në nenin 76 pika 4, Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015.</i></p> <p>Kushtet dhe procedura e transferimit dhe njohjes së krediteve bëhen me dije nga koordinatori i programit. Ndërsa kriteret dhe procedurat e përparimit, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përgjegjësi e pedagogëve dhe lehtësohen e mbështeten nga tutori i grupit. <i>(Takim me dekanin, stafin, studentët).</i> Theksojmë se diploma e nivelit të parë duhet të jetë e fushës. <i>(Evidencë 3d – Rregullorja e programit).</i></p> <p>Para cdo fillim viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR për aplikimet, pranë ambjenteve të Universitetit organizohet fushata e informimit. Stafi i ngarkuar për informim pret dhe sqaron të interesuarit me informacionin e nevojshëm për pranim.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi V.2</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të</p>	<p>GVJ konstaton se, njohjen me rregulloren e programit, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit të dijeve, konvertimin e pikëve në notë si dhe kriteret për të kaluar në vitin pasardhës e kryen përgjegjësi i programit i cili e ka detyrim institucional. <i>(Evidencë 3d. Rregullorja e programit.)</i></p> <p>Referuar RVB-së kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme dhe transferimit të krediteve përcaktohen në Rregulloren e UA dhe specifikohen në Rregulloren e programit të studimit. Ekuivalentimi dhe njohja e krediteve të fituara nga kandidati prej studimeve të mëparshme bëhet nga Komisioni i Ekuivalentimit, i ngritur nga Dekani i</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p>pjeshme.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Fakultetit. (<i>Evidencë 15. Procedura e njohjes dhe transferimit të krediteve</i>).</p> <p>Në syllabuset e moduleve përcaktohen elementët e vecantë të vlerësimit të njohurive, pikëzimi e konvertimi në notë. Studentëve iu bëhet me dije nga pedagogu përgjegjës për modulën, ditën e parë të mësimit. (<i>Evidencë 7. Syllabuset e moduleve</i>).</p> <p>Në fillim të ciklit të studimeve, Përgjegjësi i programit informon studentët mbi procedurën e diplomimit, duke lënë kohë dhe hapësirë për zgjedhjen e fushës dhe në fillim të vitit të dytë, duke u këshilluar me pedagogët, studentët plotësojnë formularin përkatës. (<i>Evidencë 26: Diploma, Formulari i përcaktimit të temës, Takim me studentët</i>).</p> <p>Cdo fillim viti, por edhe në cdo moment, studentëve dhe të interesuarve iu vihet në dispozicion informacioni mbi programin e studimit nëpërmjet faqes zyrtare, katalogut të shkollës, fletëve informuese, sekretarisë, stafit akademik dhe përgjigjesit të programit. Veprimtaria informuese intensifikohet në muajin shtator si periudhë informuese. (<i>Evidencë 31: Katalogu informues i UA</i>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.3</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve</p>	<p>GVJ vëren se, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin e procesit mësimor, orët e teorisë dhe praktikës, si edhe sezonet e provimeve nëpërmjet kalendarit akademik të prezantuar nga Përgjegjësi i programit. (<i>Evidencë 4: Dokumentet e programit, Kalendari akademik</i>).</p> <p>Në lidhje me planin mësimor, lëndët dhe modulet, studentëve u</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p>informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve.</p>	<p>vihet në dispozicion katalogu i shkollës, si dhe tabelat informuese në auditoret e leksioneve. Ata mund të marrin informacion edhe nga përgjegjësi i programit dhe tutori akademik në lidhje me veprimtaritë formuese.</p> <p>Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe ofron mbështetje institucionale për të rritur potencialin dhe për t'u mirëorientuar në tregun e punës, nëpërmjet Zyrës së Karrierës, e ngritur enkas për këtë qëllim. Zyra zhvillon aktivitete të edukimit në vazhdim dhe mban kontakte me studentë e të diplomuar për ndjekjen e karrierës së tyre profesionale. (<i>Evidencë 12, Tabelat, tabela 19</i>). Theksojmë se të dhënat e kësaj tablele i përkasin vitit 2016 – 2019, nuk ka informacion për vitin 2019 – 2020. Studentët informohen dhe përditësohen me organizimin e procesit mësimor nëpërmjet orareve mësimore, orareve të praktikave etj.</p> <p>Nëpërmjet platformës Fx Education, si sistem i brendshëm i menaxhimit të të dhënave, studentët logohen individualisht dhe njihen lehtësisht edhe në distancë me rezultatet e tyre gjatë procesit mësimor. Nëpërmjet faqes zyrtare të Universitetit Aldent, studentët mund të përdorin edhe rubrikën “portal i studentit”, në cdo kohë dhe nga cdo pajisje elektronike të lidhur me internet.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre</p>	<p>Institucioni, disponon në sekretarinë mësimore, statistikat vjetore me numrin e studentëve dhe të diplomuarve për cdo program studimi. (<i>Evidencë 12: Tabelat, tabela 16</i>).</p> <p>Referuar vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për dy vitet akademike ishte:</p> <p>Për vitin akademik 2018 – 2019 23 studentë;</p> <p>Për vitin akademik 2019– 2020 31 studentë;</p> <p>Universiteti, disponon gjithashtu, dokumentacionin vjetor me numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë “Infermieri Klinike”, ngrirjen e studimeve, largimin e studentëve gjatë ciklit të studimit. Informacioni ruhet në kohë reale dhe menaxhohet në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave nga sekretaria mësimore, nëpërmjet Fx Education. (<i>Evidencë 29: Manual përdorimi Fx Education</i>).</p> <p>Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve në formën e dokumentacionit fizik (procesverbale, regjistra), si edhe në formën elektronike në platformën Fx Education.</p> <p>Në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave, në kushte të sigurisë së plotë, kanë të drejtë dhe detyrim të hedhin dhe modifikojnë informacionin persona të autorizuar në varësi të detyrës (sekretaria, dega mësimore, tutori akademik) dhe mund të hyjnë pa të drejtë manipulimi, një kategori e caktuar personash të autorizuar. (<i>Vizitë në sekretarinë mësimore</i>).</p> <p>Referuar RVB-së, institucioni harton një raport vjetor gjithëpërfshirës, për të gjitha njësitë dhe programet që ofron. Në këtë raport analizohet edhe cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje dhe sugjerohen masa për përmirësimin e cilësisë. (<i>Evidencë 12: Tabelat, tabela 16</i>).</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



treguesve				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit,</p>	<p>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e institucionit, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendim marrëse dhe këshilluese të UA. (<i>Evidencë 1: Statuti i Universitetit "Aldent", Evidencë 3: Rregulloret e Institucionit</i>).</p> <p>Studentët organizohen në Senatit Studentor, me një senator për cdo grup mësimor, si dhe në komisione të tjera me përfaqësues studentësh si NJSBC, komisioni i kurrikulave, GVB, komisioni i kërkimit shkencor (<i>Evidencë 32: Rregulloret e Senatit Studentor</i>).</p> <p>Institucioni reagon me fleksibilitet dhe procedura jo burokratike, duke pasur parasysh faktin se një pjesë e studentëve punojnë si infermierë ose kryejnë praktikën e detyrueshme për marrjen e anëtarësimit në Urdhërin e Infermierit. Në këtë rast, institucioni konsideron si praktikë klinike aplikimin e profesionit në shërbimin aktual duke e vërtetuar me dokument të lëshuar nga drejtuesi i institucionit përkatës ose shefi i shërbimit. Përfshirja e studentëve në procese të rëndësishme akademike garantohet me pjesëmarrjen e tyre në komisione, si: komisioni i kurrikulave, NJSBC, komisioni i kërkimit shkencor.</p> <p>Studentët gëzojnë të drejtat e tyre të përcaktuara në dokumentat rregullatorë. Të drejtat e studentëve respektohen nga stafi akademik, administrativ, sekretaria dhe drejtuesit e institucionit. Ata kanë të drejtë të njihen me tezën e tyre të provimit, të komentojnë rezultatin dhe të ndjekin të gjitha shkallët e ankimimit për rivlerësim. (<i>Evidencë 3: Rregulloret e institucionit</i>).</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p>përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvehtësojnë sa më shumë dije. (<i>Takimi me stafin, Takimi me studentët</i>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi V.6</b></p> <p><b>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni lidh</p>	<p>Personeli akademik ka marrë pjesë në konferenca dhe kongrese ndërkombëtare, me prezantim oral apo postera. (<i>Evidenca 18: Cv e stafit akademik</i>).</p> <p>Universiteti Aldent ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të huaja të Arsimit të Lartë, me histori sukcesi në fushën e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p>marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p>kërkimit shkencor, me synimin që të realizojë studime të përbashkëta kërkimore, programe shkëmbimi të studentëve, shkëmbimin e të dhënave kërkimore akademike dhe materialeve teknike, organizimin e veprimtarive të përbashkëta akademike dhe shkencore si konferenca, seminare, simpoziume, etj. (<i>Evidencë 12: Tabelat, tabela 17</i>).</p> <p>Stafi akademik motivon studentët të zhvillojnë konferencën e tyre studentore dhe i fton të marrin pjesë në aktivitete shkencore që zhvillon Universiteti. (<i>Evidencë 12: Tabelat, tabela 19</i>). Nuk ka evidencë për publikime apo botime të studentëve në revista apo buletine shkencore. <i>Sugjerojmë që, një mundësi për të motivuar studentët do të ishte bashkëpunimi dhe publikimi i studimeve apo punimeve të përbashkëta pedagog – student.</i></p> <p>Institucioni akordon cdo vit një fond të vecantë në buxhet për stafin dhe studentët si mbështetje financiare për publikimin e punimeve kërkimore – shkencore në revista shkencore jashtë vendit. (<i>Evidencë 33: Projekt Buxheti</i>).</p> <p>Edhe pse programi Master i Shkencave në “Infermieri Klinike”, si një program i aplikuar në shkencat mjekësore, synon të angazhojë stafin akademik dhe studentët në rrugën e kërkimit shkencor, nuk ka mundur të përfshihet në studime inovative apo të hapë rrugë drejt patentave. UA është një institucion i mirëpajisur me laboratore, aparatura bashkëkohore dhe materiale të nevojshme për realizimin e eksperimenteve, kryerjen e analizave dhe përpunimin e rezultateve. Këto kapacitete janë shfrytëzuar për kryerjen e disa punimeve shkencore të prezantuara edhe në konferencën studentore.</p> <p><i>Sugjerojmë stafin, të shfrytëzojë më mirë kapacitetet institucionale për realizimin e temave të diplomës nga ana e studentëve, vecanërisht në orientimin infermieror të kërkimit shkencor.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

**Standardi V.7**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




**Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve				
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me QSUT, Spitalin e Traumës dhe Maternitetin “Koco Glozheni” si institucione kombëtare, në to realizohen praktikat e studentëve dhe ofrohet staf akademik i specializuar. Aktiviteti i institucionit orientohet edhe jashtë kufijve me marrëveshje ndërinstytucionale apo pjesëmarrje në projekte. <i>(Evidencë 5: Marrëveshjet)</i></p> <p>Në takimin me studentët, pyetjes se kush do të vazhdonte studimet në ciklin e tretë nëse i jepej mundësia, iu përgjigj pozitivisht vetëm një student, c’ka tregon një motivim të dobët të studentëve për vazhdimësinë e studimeve doktorale. <i>(Takim me studentët).</i></p> <p>Parimisht institucioni mirëpret studiues të jashtëm apo pjesëtarë të stafit akademik dhe mbështet projektet ambicioze që vlerësohen pozitivisht nga komisioni i kërkimit në nivel të njësisë kryesore dhe institucionale. Universiteti Aldent merr pjesë si partner në aktivitete të kërkimit shkencor dhe është i hapur për të përdorur infrastrukturën dhe laboratorët për kërkime. <i>Por, nuk ka evidencë për të dëshmuar thithjen e kërkuesve të huaj apo vendas, pavarësisht vullnetit të mirë. Gjithashtu nuk ka eksperiencë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore, vendas apo të huaj.</i></p> <p>Universiteti Aldent mbështet mobilitetin e studentëve, pjesëmarrjen e tyre në aktivitete ndërkombëtare si: shkolla verore dhe dimërore, praktika spitalore dhe zhvillimin e moduleve të ndryshme. <i>(Evidencë 8: Shkëmbimi i studentëve dhe stafit).</i> Në kuadër të programeve Erasmus + dhe CEPUS krijohet mundësia e lëvizjes së studentëve dhe stafit.</p> <p><i>GVJ evidenton se asnjë nga studentët e këtij program studimi nuk ka qenë pjesë e ndonjë progami shkëmbimi apo mobiliteti, pavarësisht se institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi.</i></p> <p><i>(Evidencë 8: Shkëmbimi i studentëve dhe stafit).</i></p>				
Shkalla e përmbushjes së	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="589 1791 781 1837">Nuk</td> <td data-bbox="781 1791 1003 1837">Përmbushet</td> <td data-bbox="1003 1791 1226 1837">Përmbushet</td> <td data-bbox="1226 1791 1435 1837">Përmbushet</td> </tr> </table>	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet		




standardit	përmбуshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Standardi V.8	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Bazuar në Ligjin “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në Statutin, Rregulloren, si edhe udhëzime e akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, Senati Akademik i UA, në mbledhjen e tij të datës 10.09.2015, miratoi Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Tutoriatit”.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krahas veprimtarisë akademike, strukturat mësimore zhvillojnë si veprimtari institucionale edhe kujdestari për studentët, këshillim për përzgjedhjen e programeve të studimit, si edhe orientim për përfshirjen në tregun e punës;</li> <li>• Organikisht Shërbimi i Tutoriatit është ndërtuar në formën e një piramide me bazë të gjerë, të përbërë nga të gjithë tutorët, që kulmon me Rektorin dhe Administratorin e Përgjithshëm dhe që ka në qendër studentin;</li> </ul> <p>(Evidence 3: RREGULLORET, Rregullore e Tutoriatit)</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e	<p>Në Universitetin ALDENT funksionon Zyra e Zhvillimit të Karrierës, e cila ofron këshillim për zhvillimin e një karriere të sukseshme për të gjithë studentët. Shërbimet që ofrohen në këte njësi janë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Njohja e potencialeve dhe shprehive vetjake</li> <li>➤ Identifikimi i lidhjeve midis diplomës që zotëron dhe mundësive për karrierë,</li> <li>➤ Identifikimi i burimeve për pozicione të vecanta pune</li> <li>➤ Udhëheqje akademike</li> <li>➤ Zhvillimi i strategjive për mënyrën e të kërkuarit te punës</li> </ul>

punës.	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Identifikimi i aftësive dhe shprehive</li> <li>➤ Shkrimi i rezymeve, letrave të interesit dhe CV-ve</li> <li>➤ Prgatitja për intervista pune</li> <li>➤ Përcaktimi i direktivave të karrierës.</li> </ul> <p>( Evidencë3: RREGULLORET, Regullore e Zyrës së Zhvillimit të Karrierës, Takim me Përfaqësues të Zyrës së Zhvillimit të Karrierës)</p> <p>Zyra e karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar, mban të dhëna për ALUMNI nëpërmjetnjë accounti në rrjetet sociale dhe publikon njoftime për aktivitete të edukimit në vazhdim, të organizuara nga UAL, apo shpall oferta punësimi.</p> <p>( Takim me Përfaqësues të Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës)</p>			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

<b>Standardi VI.1</b>	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore	Në RVB, si edhe në takimin me përfaqësues të NjSBC, u cilësua se: Bazuar në Nenin 103 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë: “Institucionet e Arsimit të Lartë janë përgjegjëse për hartimin e

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p>në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë”. Struktura dhe funksionimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) përcaktohen në Statutin e Institucionit të Arsimit të Lartë. Në zbatim të këtij neni, Senati Akademik i UA ka miratuar Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (<i>Evidenca 3 Rregulloret e institucionit, Rregullore e NjSBC</i>)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka ngritur një Sistem të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili funksionon në bazë të elementëve të mëposhtëm</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbështet dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bashkërendon procesin ndërmjet njësisë në nivel institucional;</li> <li>- Interpreton detyrimet kombëtare dhe europiane të sigurimit të cilësisë;</li> <li>- Monitoron procesin, ofron udhëzime, mbledh informacione, evidenton problem;</li> <li>- Administron dokumentacione, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësisë përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përcakton pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë në disa nivele;</li> <li>- Lehtëson krijimin e një mjedisi të favorshëm me studentin në qendër, për arsimim cilësor dhe zhvillimin e stafit akademik për një proces me pjesëmarrje aktive gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies;</li> <li>- Siguron informacion për cilësinë e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të Universitetit;</li> </ul> <p>Në përbërje të NjSBC përfshihen përfaqësues të Fakulteteve, një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues i Unionit Studentor (<i>Evidencë 12: TABELAT, tabela 10</i>). Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL.</p> <p>Në funksion të sigurimit dhe përmirësimin të cilësisë NjSBC dhe Përgjegjësit e programeve, përgatisin raporte periodike të vetëvlerësimit, të cilat i propozohen Senatit Akademik për miratim (<i>Evidencat: Evidenca 34, Raporti i NjSBC</i>)</p> <p>NjSBC monitoron dhe vlerëson procedurat dhe standartet, duke</p>

	<p>analizuar dhe krahasuar rezultatet në bazë të treguesve të cilësisë, në bazë të kriterëve dhe standarteve të paracaktuara për krijimin e kulturës së cilësisë në institucion (<i>Evidenca 34, Raporti i NjSBC</i>)</p> <p>(Takim me përfaqësues të NjSBC)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.2</b>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit dhe përmirësimi i tij kryhet nga njësi ofruese e programit të studimit dhe NjSBC nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ristrukturimit të programit të studimit sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore;</li> <li>- standarteve dhe kriterëve të studimeve;</li> <li>- cilësisë dhe numrit të nevojshëm të stafit akademik;</li> <li>- politikës së përzgjedhjes së teksteve universitare dhe aplikimit të teknologjisë bashkëkohore;</li> <li>- infrastrukturës mësimore, monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm dhe akreditimit;</li> </ul> <p>UAL përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas herë të programit të studimit. Vetëvlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe cilësore nga burime të ndryshme, me qëllim përmirësimin e mësimnxënjes së studentëve dhe vlerësimin e përmbushjes së standarteve akademike. Në rastin e akreditimit hartohet nga GVB në nivel programi, miratuar nga Senati Akademik. (<i>Evidenca 17: Vendime SENATI, a. Vendim Senati për ngritjen e GVB</i>)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe</p>	



vendimmarrëse për programin e studimit.	UAL përdor metodologji vlerësimi, instrumentat matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbajtjen e programit të studimit si Treguesit e performancës akademike apo pyetësorin e studentëve. (Evidenca 22, Formular i performancës akademike, Evidenca 21, Pyetësori I studentëve)			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Strukturat e ndryshme të SBC, Dekani i Fakultetit, përfaqësuesi i NjSBC në programin e studimit mbikqyrin zbatimin e programit mësimor. Raporti i hartuar nga NjSBC i kalon Rektorit, i cili e shtron në Senatin Akademik për të marrë masat dhe vendimet e duhura për përmirësimin e performancës dhe cilësisë. NjSBC cdo fun dvti akademik publikon Raportin Vjetor, në përmbajtjen e të cilit përshkruhet edhe plani i masave për përmirësimin e treguesve me vlerë të ulët. (Evidencë 34: Raport Vjetor i NjSBC, 2019 )			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	NjSBC, mbi bazën e të dhënave të mbledhura, harton Raportin Vjetor të NjSBC, i cili vihet në dispozicion të rektoratit. Këto të dhëna janë bazë për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe vetëvlerësimit. Institucioni kryhen një analizë gjithëpërfshirëse vjetore dhe paraqet Raportin vjetor të Universitetit. Ky raport dërgohet konform legjislacionit edhe në MASR (Evidencë 35: Rapori Vjetor i UAL-2019)  Duke qënë i profilizuar në ofrimin e programeve të studimit në fushën mjeksore, metodat dhe instrumentat e përdorur janë specifike dhe në përputhje me fushën akademike.  <u>Metoda të drejtpërdrejta:</u>
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni	Stafi akademik dhe administrativ i Universitetit fton studentët në diskutime të hapura dhe iu mundëson shprehjen e lirë të mendimeve

<p>përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>dhe vërejtjeve në lidhje me procesin akademik.</p> <p>Vlerësimi i studentëve, si pjesë e procesit akademik, bazohet në Statutin, Rregulloren e Përgjithshme dhe Rregulloret e programeve të studimit.</p> <p>Procesverbalet e provimeve janë pjesë e dokumentacionit mësimor, ato hartohen dhe ruhen konform legjislacionit dhe akteve rregullatore. (<i>Vizitë në Sekretarinë Mësimore</i>)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Për vlerësimin e studentëve përdoren të gjitha format ligjore, testimet, vlerësimet në seminare, detyra kursi, projekte, prezantime në poëer point, etj.</p> <p>Nuk ka pasur raste të vlerësimit paralel të provimeve apo detyrave të kursit apo vëzhgime në auditor, si edhe testime të standartizuara. Por, stafi bazohet në pyetjet e provimit të shtetit për profesionet e rregulluara, në hartimin e tezave te provimeve.</p> <p><u>Metodat e tërthorta</u></p> <p>Institucioni përdor pyetësorët studentorë dhe sistemin e Tutoriatit. Pyetësorët studentorë dërgohen on-line, jane anonimë konform rregullores të etikës.</p> <p>Në Raportin e Vetëvlerësimit 2019 shkruhet se studentët që kanë plotësuar pyetësorin plotësisht ose pjesërisht janë 525 në numër ose 32% të numrit prej 1637 kontaktesh të dërguara dhe nga Msc Infermieri Klinike vetëm 3 studentë. <i>Ky është një numur I pa përfillshëm studentësh që e bën të pavlefshëm përdorimin e pyetësorit si indikator vlerësues për këtë program studimi, ndonëse vlerësimi i përgjithshëm i studentëve ka qënë mjaft pozitiv, vecanërisht në treguesit kryesorë, të cilët tregojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë cilësinë e mësimdhënies dhe aktivitetin akademik (Raporti vjetor NjSBC 2018-2019 fq.17)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe</p>	<p>Pakënaqësia e disa studentëve në lidhje me vlerësimin:</p> <p>Të gjithë studentët kanë mundësi të ankimojnë rezultatet dhe të kërkojnë nga komisionet rivlerësim të tezave. Për sa kohë kjo e drejtë është ushtruar, komisionet janë të pavaur për të vendosur në lidhje me vlerësimin përfundimtar. Në mjaft raste ka pasur monitorime edhe nga NjSBC dhe procedura ka qënë korrekte në përputhje me rregulloren. (<i>Raport vjetor NjSBC 2018-2019, faqe 18</i>). Stafit mësimdhënës dhe mbikqyrësve të praktikave u kërkohe</p>




palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program	raporte mbi problematikat e hasuara gjatë procesit akademik në universitet apo institucionet spitalore.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në përbërje të NjSBC ka aktorë që përfaqësojnë grupe të ndryshme interesi, nga një anëtar për cdo fakultet, një ekspert të jashtëm si dhe një përfaqësues studentësh, me një synim të përbashkët: përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. <i>(Evidencë 17: Vendimet e SENATIT, Vendimi për përcaktimin e anëtarëve të NjSBC)</i>  Gjatë vizitës në institucion, GVJ u takua me aktorë të rëndësishëm të jetës akademike, Dekanin e Fakultetit, Përgjegjës të Departamentit, Përfaqësues të Stafit Akademik të brendshëm dhe të jashtëm, me Grupin e Vetëvlerësimit me përfaqësues të NjSBC dhe Zyrës së Karrierës. Në këto takime doli në pah organizimi i mirë i punës së përditshme, angazhimi optimal në procesin e akreditimit, motivimi, përgjegjësia dhe entuziazmi për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Duke qënë në unison, për një proces sa më korrekt dhe me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e veta, institucioni tregoi aftësi menaxhuese dhe drejtuese largpamëse dhe përforcoi ndjesinë pozitive se stafi jep më të mirën duke punuar e bashkëpunuar konform rregullave, në harmoni të plotë. Cdo grup është i pavarur, i barabartë, ushtron kompetencat në përputhje me autonominë që u siguron legjislacioni.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Edhe studentët shprehen pozitivisht dhe gëzojnë të drejtat e tyre, ashtu sic njohin edhe detyrimet akademike, cka u vu re gjatë
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e	

<p>njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>bashkëbisedimit me përfaqësinë studentore, përgjatë vizitës që GVJ zhvilloi në institucion. Por roli i studentëve në këtë program është i papërfillshëm, në anketimin e zhvilluar on-line, cka vë në pah indiferencën e këtij grupi interesi.</p> <p><i>Do të rekomandonim gjetjen e mundësive nga ana e institucionit për të zgjuar interesin e studentëve me forma apo metoda që të nxisin pjesëmarrjen aktive të studentëve të këtij program studimi në realizimin dhe sigurimin e cilësisë së programit. (Takimet gjatë vizitës në institucion )</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.5</b></p> <p><b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika,</p>	<p>Synimi i institucionit është zgjidhja e cdo problemi që raportohet</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p>strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>nga auditimet e strukturave të institucionit, anketimet e studentëve, diskutimet e pedagogëve dhe të gjithë aktorëve të përfshirë në proces,</p> <p>NjsBC cdo fund viti akademik publikon raportin vjetor, i cili i përcillet senatit akademik, Ky raport, në mënyrë të detajuar i përcillet Rektorit, ndërsa publikohet një përmbledhje e tij pa emra konkretë. Në senatin Akademik diskutohen problematikat e evidentuara dhe në mënyrë individuale komunikohen gjetjet problematike.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Raporti vjetor i NjsBC së bashku me planmasat e sugjeruara kalohet në Senatin Akademik, i cili merr vendimin për masat që duhen marrë për përmirësimin e defekteve. Vendimet e Senatit synojnë zgjidhjen efektive të problemeve në drejtim të përnirësimit të cilësisë. Senati ka autoritetin e implementimit dhe monitorimit të masave që merr në vendimet e tij,</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Përfaqësuesi i NjsBC, shërbimi i tutoriatit akademik si dhe përgjegjësit e programeve janë garant për ndërgjegjësimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë, duke krijuar në institucion kulturën e Brendshme të Cilësisë.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<p><b>Nuk</b></p>	<p><b>Përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet</b></p>




standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

### Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Infermieri Klinike”

#### a. Pika të forta dhe afirmime;

1. Programi ofrohet nga një Institucion i Arsimit të Lartë me eksperience dhe i mirë konsoliduar në fushën e shkencave të shëndetit;
2. Kapacitete të larta dhe mundësi të mira si të stafit akademik ashtu edhe infrastrukturore për përmisimin dhe zhvillimin e këtij programi studimi;
3. Staf akademik i motivuar, bashkëpunues dhe i përgatitur, i cili shërben si një garanci për rritjen e cilësisë së programit dhe studentëve të diplomuar;
4. Ofrimi i praktikave profesionale në Institucione spitalore e asistuar nga profesionistë të dedikuar të fushës;
5. Infrastruktura e mirëpaisur me auditore, atelie dhe laboratore të infermieristikës të cilët krijojnë mundësinë e zhvillimit cilësor të programit të studimit;
6. Bibliotekë e mirëpaisur dhe me një numër të lartë titujsh profesionale;

#### b. Pika të dobëta:

1. Numër i vogël i stafit akademik efektiv, duke ndikuar negativisht në mbulimin e ngarkesës mësimore në masën 70% nga staf efektiv konform akteve ligjore në fuqi;
2. Përfshirje e ulët e studentëve të këtij programi në programe shkëmbimi apo mobiliteti;
3. Mosangazhim i personelit ndihmës mësimor – shkencor për realizimin e orëve laboratorike sipas natyrës specifike të programit;

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




4. Literatura e detyruar vënë në dispozicion të studentëve në një pjesë të syllabuseve rezulton të jetë më e vjetër se e pesë viteve të fundit;

***Rekomandime:***

1. GVJ rekomandon që Institucioni të marrë masa për rritjen në numër të stafit akademik, për të përmirësuar mbulimin e ngarkesës mësimore në masën mbi 70% nga staf akademik efektiv (PAE), konform VKM Nr. 418, datë 10.05.2017;
2. GVJ rekomandon rritje të përfshirjes së studentëve të këtij programi në programe shkëmbimi apo mobiliteti të aplikuar nga institucioni;
3. GVJ rekomandon angazhimin e personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit në plotësim të Kriterin 5 të Standartit II. 5;
4. GVJ rekomandon të përditësohet literatura e detyruar, vënë në dispozicion të studentëve ku në një pjesë të syllabuseve rezulton të jetë më e vjetër se pesë viteve të fundit;
5. GVJ rekomandon që institucioni të krijojë mundësinë për të zgjuar interesin e studentëve me forma apo metoda që të nxisnin pjesëmarrjen aktive të studentëve të këtij program studimi në realizimin dhe sigurimin e cilësisë së programit;
6. Të plotësohet dokumentacioni i studentëve me diplomat e mbrojtjes së gjuhës së huaj, në përmbushje të kriterëve të pranimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve bazuar në nenin 76 pika 4, Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015;
7. GVJ rekomandon rritjen e numrit të marrëveshjeve me institucione të tjera shëndetsore shtetërore dhe private;

**Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master of Science in "Clinical Nursing"**



**a. Strengths and affirmations:**

1. The program is offered by an experienced and well-established Higher Education Institution in the field of health sciences;
2. High capacities and good opportunities of both, academic and infrastructural staff, for the improvement and development of this study program;
3. Motivated, cooperative and prepared academic staff, which serves as a guarantee for increasing the quality of the program and of graduate students;
4. Providing professional internships in hospital institutions assisted by dedicated professionals in the field;
5. Well equipped infrastructure with auditoriums, ateliers and laboratories of nursing which create the possibility for quality development of the study program;
6. Well-equipped library with a high number of professional titles;

**b. Weaknesses:**

1. Small number of effective academic staff, negatively affecting the coverage of the teaching load in the amount of 70% of effective staff in accordance with applicable laws;
2. Low involvement of students of this program in exchange or mobility programs;
3. Non-engagement of teaching-scientific support staff for the realization of laboratory classes according to the specific nature of the program;
4. The compulsory literature made available to students in some of the syllabus turns out to be older than the last five years;

**Recommendations:**

1. EEG recommends that the Institution takes measures to increase the number of academic staff, to improve the coverage of the teaching load to the extent of over 70% of effective academic staff (PAE), in accordance with DCM no. 418, dated 10.05.2017;
2. EEG recommends increasing the involvement of students of this program in exchange or mobility programs applied by the institution;
3. EEG recommends the engagement of teaching-scientific support staff for the realization of laboratory classes and for the maintenance of laboratories and other learning



environments, according to the specific nature of the program in addition to Criterion 5 of Standard II. 5;

4. EEG recommends updating the compulsory literature, made available to students where in some of the syllabi it turns out to be older than the last five years;
5. EEG recommends that the institution creates the opportunity to arouse the interest of students with forms or methods that promote the active participation of students of this study program in the implementation and quality assurance of the program;
6. To complete the documentation of students with diplomas of foreign language protection, in fulfillment of the criteria for admission of students in the second cycle of studies based on article 76 point 4, Law on Higher Education 80/2015;
7. EEG recommends increasing the number of agreements with other state and private health institutions;



**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

Dr. Nevila HETA



Dr. Elda NUNI



Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)


